



Shkrime të padobishme

Ismet Ozel

UVERTURË NË "BOTËN" E OZELIT

Leximi i veprave të Ismet Ozelit është një përpjekje për të kuptuar, për të bashkëjetuar dhe për t'u "ushqyer" nga një poet, filozof, sociolog, mendimtar origjinal e i shkëlqyer, i cili, - siç tregon edhe titulli jo i zakonshëm i veprës në fjalë, - nuk vuan nga psikoza se ç'jehonë do të ketë ideja e re e lëshuar në eter. Ai është një botë më vete, një idhullthyes që asnjëherë nuk pajtohet me status quo-në (kuptohet, atë negative, d.m.th., nuk është anarkist që me çdo kusht dhe me sy të mbyllur dëshiron ta ndryshojë gjendjen ekzistuese), e posaçërisht nuk pajtohet me status quo-në ose thënë më mirë letargjinë dhe gjumin disashekullor të botës islame. Ai vazhdimisht jep mesazhe, përkujton dhe tërheq vërejtjen.

Ozeli sugjeron që t'i thuhet "Non paseran" (nuk do të kalojë, s'ka kalim) paditurisë, imitimit, snobizmit, dembelizmit, puthadorisë, narcizmit, iluzionizmit etj., ndërsa i shkruan "med'hijje" (eulogji) kreativitetit, origjinalitetit, nderit, vetëdijes, zgjuarsisë...!

Ai nuk është një Sizif musliman, e as një idealist e as socialist utopik që e shikon me syze hiper-optimiste e iluzioniste ardhmërinë, ai nuk e hyjnizon përparimin linear, teknologjinë dhe qytetërimin por bën me gisht kah e vërteta e hedhur pas shpine, kah e kaluara reale ideale, kah Shekulli i Lumturisë i cili do të shërbejë si background për kthimin e ditëve të lumturisë; e për arrijten e një ardhmërie të ndritshme ofron edhe paradigmen: Kthimi kah transcendentalja, e shenjta, sublimja, shpirtëroja. Përparimi* të cilin e parashihet Ozeli është një përparim duke bërë udhëtim dhe duke iu referuar në ide, emocione dhe jetë-praktikë historisë së ndritshme, praxisit të personaliteteve shembullore, një përparim që aktualen dhe të ardhshmen i qëndis me të kaluarën (krijon një trekëndësh të pashkëputshëm, cungimi i të cilit shkakton deformime të mëdha), një përparim ku hapat bëhen duke e pasur në konsideratë të kaluarën shembullore por jo duke e mitologjizuar atë (sepse miti, legjenda nuk ka vend në shpirtin islam), as duke iluzionuar ishuj të paqenë (inekzistentë) të lumturisë; ai është për një sintezë jetësore ku brumosen vija horizontale (botërore) me vertikalen (tejbëtëroren).

Sipas tij njerëzimi ka vetëm dy alternativa: të zgjedhë idetë dhe ideologjitë që për bazë e marrin lëndoren, materialen ose fenë dhe fetaren që për bazë e marrin hyjnoren, metafiziken dhe të shenjtën. Nëse anon kah alternativa e parë, përfundimi do të jetë një obskurantizëm i quajtur iluminizëm, përparim, progres etj., ndërsa nëse e zgjedh alternativën e dytë do të takohet me Vox Dei-n (Zërin e Zotit), do të shpëtojë në kohëbotë (dynja) dhe pakohëbotë (ahiret). Nëse e zgjedh mundësinë e parë mbetet i mangët, mbetet vetëm homo sapiens, homo faber, homo economicus, homo ludens etj., ndërsa nëse e zgjedh të dytën i kthehet natyrës së vet si homo primigenius, para karakteristikave të lartpërmendura e pozicionon tiparin e vet prej homo religiosus-i dhe duke krijuar një unitet qenësor të karakteristikave njerëzore bëhet njeri në plotkuptimin e fjalës, e meriton atributin "krijesa më e ndershme në sipërfaqen e tokës".

Sado që në shikim të parë lexuesit tekstet i lënë një përshtypje se janë tepër të mbyllura ose të mjegullta e të pakapshme, më vonë do të vërejë se është duke lexuar diçka sui generis, origjinale, se rreshtat dhe mesrreshtat "vlojnë" nga kuptime që e freskojnë zemrën e ndonjëherë edhe të lënë në një nebulozë nga e cila duhet të përpiqesh të dalësh vetë dhe ta gjesh diellin duke u nisur nga rrezet në horizont. Kjo është dinamika e Ozelit i cili nga qarqet e ndryshme (islamiste, djathtëste-westerniste dhe majtiste-marksiste) çmohet si njëra nga penat më të ndritshme të Turqisë "bashkëkohore", e unë do të kisha thënë "njëri nga mendimtarët më të mëdhenj që bota islame ka dhënë në shekullin XX".

Më duhet të pranoj se gjatë përkthimit shpesh hasja në pika ku mbetesha pa tekst për ta shqipëruar të thënë në origjinal. Kjo ndoshta është normale kur kemi parasysh të vërtetën se lexuesit turkofonë kur flasin për Ozelin e lavdërojnë por dhe e kritikojnë se tepër e "djersit" lexuesin. Sidoqoftë, mendoj se kjo vepër do të plotësojë një zbrazëtim në opusin e përkthimeve në gjuhën shqipe dhe do të jetë nxitje për ide të reja, vlerësime dhe kritika ftytdhënëse. Nuk mund e të mos them se thesar në vete paraqet gurra e bujshme poetike e autorit, të cilën do t'ua kisha rekomanduar përkthyesve entuziastë të këtij lëmi dhe botuesve shqiptarë që "dinë ta gjuajnë cilësoren".

Në fund më duhet t'i falënderoj autorit i cili ndau kohë që të zhvillojë një bisedë vëllazërore me përkthyesin dhe t'ia ndriçojë disa pika kyç rreth tekstit dhe jetës në përgjithësi.

Gabimet në përkthim janë të miat, e qëlluara është nga i Madhi Zot.

*Përkthyesi
21 janar 2000
Kadikoj-Stamboll*

*Sa një dru që s'jep fruta
të padobishme le t'jenë këto shkrime të mia.
Askush duke synuar frutat e tij
le t'mos ketë shkas të gjuajë gurë degëve.
Këto shkrime le të jenë të padobishme
sa një dru shumëdegësh, shumë i shtrembër.
Atëherë marangozët
s'do ta shohin të vlerë ta presin e gdhendin.
Sa një dru trungbosh, vrimëgjërë, i parrëshirë
le të jenë të padobishme këto shkrime të mia.
"Nuk vlen për djegie ky dru,"-le të thonë,
le të mos e djegin.
Prap të padobishme le të jenë!
Si një dru, le të jenë këto shkrime të mia:
Që rrënjët i ka në tokë,
degët kah qielli.
Mbase askush s'e mbjell në bahçe,
e as s'e vënë në bulevardin e qytetit.
Por, nëse në një vend të largët e të thatë
një udhëtar i trulluar
gëzohet e freskohet
ngase gjeti një dru
ku do ta mbështesë shpinën e do të çlodhet,
mjafton kjo.*

(i inspiruar nga Chuang Tzu)

PARATHËNIE OSE MANGËSISHFAQJE

Turqia nuk është një vend ku mendimi konsiderohet vlerë. Mendimin dhe njerëzit që e përfaqësojnë atë, nuk i merr nën mbrojtje as shteti e as ndojnë institucion tjetër. Pikërisht për këtë arsye nuk ekziston një rreth shkencor, artistik dhe filozofik i përkufizuar qartë. "Të këndueshmit tanë" (inteligjencia-A.P.), të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë e bartin ndikimin e vulshmërimin politik, vulën specifike të shekullit XIX bon pour l'orient ende janë duke e përdorur si një element presioni dhe autoriteti kundër popullit të vet. Para një njeriu i cili inkuadrohet në botën e mendimit brendapërbrenda problemeve të këtilla shfaqen dy rrugë: E para, ta bëjë të pranueshme ekzistencën/praninë e vet duke treguar ndonjë aftësi personale dhe duke iu falënderuar rendimentit të kësaj pranueshmërie ta ruajë lidhshmërinë me botën e mendimit. Por, kjo është një rrugë e pasigurt që e vë në rrezik edhe vetë mendimin. Personi i cili e zgjedh këtë rrugë do të jetë i detyruar që në mënyrë permanente të tregojë aftësinë që ia ka hapur dyert drejt rrugës së botës së mendimit dhe këto të bëma të tij do të bëhen pengesë që ai t'i qaset mendimit në dimensionet e tij të vërteta. Rruga e dytë, që njerëzit të cilët ia kanë lidhur jetën mendimit dhe të menduarit ta vazhdojnë ekzistencën e vet, është të hyjnë nën ombrellën e ndonjë ideologjie politike që gëzon autoritet në shoqëri. Është e paevitueshme se ata që e kanë zgjedhur këtë rrugë do të vërejnë se kanë mbetur të burgosur në strehimoret e veta. Sepse ideologjitë nuk mund të qëndrojnë "në këmbë" pa ndihmën e mashtimit kolektiv, kurse mendimi e mbron ndriçimin (iluminacionin) kolektiv. Unë i takoj një drejtimi që beson se ndriçimi gjendet në pjesëmarrje/kolektivitet. Besoj se e vërteta nëse nuk ka karakter kolektiv, pa marrë parasysh rëndësinë dhe vlerën që ka, mbetet larg njeriut dhe njerëzores. E di se gjëja e rëndësishme, e vërteta dhe dituria të cilës i atribuohet vlerë por që nuk përjetohet nga të gjithë, shumë lehtë mund të shndërrohet në idhull (idol). Lidhshmëria ndaj ideologjisë mund të arrijë deri në dëbimin e të vërtetës për hir të kolektives. Përveç kësaj, ata që bëjnë apologjinë e superioritetit të së vërtetës, -madje edhe nëse nuk e përjetojnë atë (të vërtetën) - prej momentit kur i shtien në dorë rastet njerëzore, gradualisht shndërrohen në funksionarë të presionit, eksploatimit dhe dhunës në sipërfaqen e tokës. Përpjekja ime është në drejtim të llogaritjes të së vërtetës (Hakk) për vlerë më të lartë dhe të diturit se kusht i depërtimit të vlerës më të lartë në jetën tonë është përbashkësia e saj. Nga përfundimet e punimeve të mia në fushë të poezisë kam mësuar se, asnjë shenjë që nuk e ka vërtetësinë (autenticitetin) e vet, nuk mund të gjejë refleksion te njerëzit. Jam i mendimit se e njëjta gjë vlen edhe për idetë. Domethënë vetëm nëse e shfaqim edhe të vërtetën edhe kolektiven pa e lënduar njëra-tjetrën, mund të zotërojmë mendime autentike dhe të mbetemi njerëz autentikë.

A thua pse duhet të orvatemi për të arritur mendime autentike? Në gjuhën tonë apelativi "njeriu që kujtohet" e ka kuptimin e "njeriut të mërziut". Mendoj se të qenët i mërziut, të cilin gjendja e përgjithshme e njerëzimit e ka bërë të paevitueshëm, është një dukuri që duhet vënë në hesap. Përndryshe, nuk dyshoj fare se përdorimi i mendimit si mjet për të arritur në një pozitë të privilegjuar, njerëzve nuk u sjell dobi por vetëm dëm. Njeriu i thelluar në mendime nuk bën vetëm një hap drejt mendimit; ai në të njëjtën kohë është i hedhur në mendime. Lidhjen e njeriut me mendimin e determinon fati i tij i paracaktuar (kaderi). Për këtë arsye, thellimin në mendime nuk duhet llogaritur as si shkak për urrejtjen e personit gjegjës e as për dashurimin e tij. Tërësinë e këtyre shkrimeve të cilat i titullojmë Shkrime të padobishme pranonie si një prezentim të projeksioneve të një njeriu që ndjek rrugën e ndriçimit të vetvetes, me qëllim të ndarjes së tyre (projeksioneve) me të tjerët.

*13 shkurt 1986
Bejlerbeji-Stamboll*

SNOBIZMI DHE KULTURA

Në Turqi, në rrethin letrar dhe kulturor, me qëllim të arritjes së statusit të elementit kryesor, vazhdimisht janë duke pritur në pusi dy tendenca sterile dhe kalbëzuese. E para, përpjekja e paaftësisë mendimore dhe vulgaritetit në shije që t'ia hapin rrugët vetvetes në emër të "besnikërisë ndaj doktrinës"; e dyta, përpjekja e vlerave të rreme për t'i çelur rrugë vetes duke dhënë pamjen se janë pranë (madje se e përfaqësojnë) thellësisë mendimore dhe lartësisë në nivelin artistik. Vendmbërritja e tendencës së parë, varësisht nga klima ku jeton e njëjta, mund të emërtohet si "zhdanovizëm", "puritanizëm", "radikalizëm"; tendencës së dytë, në të gjitha klimat ideore mund t'i ngjitet emri i njëjtë: "snobizëm".

Në gjuhët evropiane për ta emërtuar personin me karakter të këtillë ekzistojnë dy nocione: 'snob' (sqimatar, snob) dhe 'dandy' (kokorosh, dendi, spitullak). Kur kemi të bëjmë me artin dhe mendimin, këto dy fjalë duhet ndarë me një kujdes të posaçëm. Përderisa snobisme, snobbery në të shumtën e rasteve mund të konsiderohet si një degradim shpirtëror dhe degjenerim, dandysme, dandyism ca herë mund të na dalë para si rrugëdalja më e shëndoshë karshi degjenerimit.

Shpjegimin e qëndrimeve të mia në këtë subjekt do ta filloj, duke u bazuar në disa fjalorë të gjuhëve evropiane, me ndriçimin e këtyre dy llojeve të snobizmit. Kjo, për arsye se ndër dhëlpëritë më të preferuara të snobëve është "dhënia fjalëve të përdorura domethënie të ndryshme duke i mospërfillur në tërësi fjalorët".

Në fjalorin Webster lexojmë se fjala snob në dialektin e Francës Lindore ka kuptimet "këpucëtar", e në kuptimin e vjetëruar "pjesëtar i klasave të ulëta"; kurse në fjalorin Le Petit Robert lexojmë se kjo fjalë është me origjinë angleze dhe ka kuptimin e "këpucëtarit". Në argon e Universitetit Cambridge snobë u thuhet njerëzve jouniversitarë.

Sipas fjalorit të gjuhës angleze fjala snob përkufizohet si vijon:

1. Person i cili me mish e me shpirt i imiton njerëzit që i konsideron më të lartë se vetja dhe që në mënyrë jodinjitoze mundohet të bëhet "bashkudhëtar" i tyre.
2. a. Person që mundohet t'i hedhë mbrapa arritjet e individëve që ai i konsideron për më të ulët se vetja. b. Person që në çështjet e dijës ose shijës rrah gjoks për superioritet (epërsi).

Sipas fjalorit të gjuhës frënge snob do të thotë: individ i cili duke i reflektuar me mburrje sjelljet, shijet dhe modat që i ka huazuar nga njerëzit e zgjedhur mondanë, pa treguar ndonjë aftësi mendore dhe pa pasur nevojë, mundohet t'i gjejë rrugët e homogjenizimit me pjesëtarët e atij grupacioni dhe i mbron raportet e këtilla.

Sipas fjalorit të gjuhës angleze, fjala dandy (në spektrin që ka të bëjë me temën tonë) ka këto kuptime:

1. Person që kujdes të tepërt i kushton veshjes;
2. Person i aftë në klasën e vet;
3. Snobisht, snobçe;
4. Një metodë e letërsisë dhe artit nga fundi i shek XIX që është dalluar me një subtilitet, precizitet artificial dhe jooriginal.

Sipas fjalorit të frengjishtes dandy do të thotë: individ që bën përpjekje të mëdha për të treguar elegancë në veshje dhe sjellje; dandysme: (në letërsi) pasion pas elegancës, subtilitet specifik i dandy-t. (shek. XIX)

Për ta kuptuar sërën e ndodhive në nënqiellin tonë letrar dhe kulturor nuk duhet shtuar ndonjë gjë të shprehurave nëpër fjalorë; por meqë ky shkrim synon ringjalljen e shpresës në kuadër të një rajoni kulturor ku mendimi dhe arti i vërtetë, që jetojnë të mbërthyer me

problemet e njeriut të rëndomtë, do të pastrohen nga fanatizmi dhe snobizmi, do të prekë edhe çështjen e snobizmit në kuadër të dinamizmit kulturor si dhe kushtet që e ushqejnë atë në shoqërinë e ditëve tona.

Snobizmi është në një marrëdhënie të kuptimtë me mendimin dhe artin. Dinamizmi kulturor, si sot ashtu edhe në çdo periudhë historike, i ka ofruar hapësirë jete snobizmit. Për këtë arsye, duke e shikuar "të renë", gjithmonë bartim tensionin nëse jemi ballëpërballë me një realitet ose falsitet të thellë. Ky tension paraqet një refleksion të domosdoshëm të cilësive lidhur me burimin e mendimit dhe artit. Në një aspekt, "mendimi ka lindur nga mossuksesi. Sfondi për lindjen e mendimit formohet atëherë kur aksioni tregohet i pasuksesshëm në plotësimin e nevojave të njeriut. Përqëndrimi i kujdesit në një çështje të caktuar paraqet pranimin e mangësisë së kalibrimit (që na ka ikur dorësh), kur (për një moment) kemi ndjerë domosdoshmërinë të ndalemi dhe të bëjmë llogarinë".

Nëse vazhdojmë të mendojmë në kahje të njëjtë, do të vijmë në përfundim se edhe arti ka lindur nga mossinqeriteti. Në rrethin e privuar nga sinqeriteti, artisti gjithherë do ta kërkojë sinqeritetin e mbetur në vendet e thella dhe të largëta, do dojë të arrijë në thelbin e marrëdhënieve ndërnjerezore. Në një aspekt, çdo vepër artistike paraqet një dokument të plagosshmërisë së autorit të veprës (artistike) dhe koniukturës shoqërore që ka shkaktuar lindjen e saj. Mund të themi se mendimi kërkon suksesin, kurse arti sinqeritetin.

Mendimi nuk është vegël që e bën të mundshëm suksesin, por prapëseprapë gjithmonë presim që mendimi të jetë sukses. Domethënë presim që i njëjti (mendimi) të "korrespondojë" me një realitet jashtë vetes. Në këtë mënyrë ai e siguron realitetin e vet. S'ka mundësi që arti të jetë sinqeritet në vetvete, sepse ai ekziston për t'ia zënë vendin sinqeritetit. Krahas kësaj artin, si një mjet, art mund ta bëjë vetëm sinqeriteti i vet. Sinqeriteti i artit mund të gjendet vetëm në mundësinë e tij për vajtjen prej "thelbit" në "thelb".

Por rrethanat nuk lejonjë gjithmonë që marrëdhëniet ndërmjet mendimit dhe realitetit, realitetit dhe artit të jenë të kthjellëta e të çiltra. Fundja, relacioni për-fund-imitar ndërmjet mendimit dhe artit me realitetin është i karakterit joverbal. Ja pra, snobi gjen hapësirën e gjallërimit në rrethin ku nuk dihet kundërvlera të cilën e synon mendimi dhe ku arti nuk e kryen funksionin e "lajmërimit" prej "thelbit" në "thelb".

Kurse, dandy, për të vepruar nuk ka pasur dhe nuk ka nevojë të kërkojë kohë "të mjegullt" sepse pasi që është "i ndotur" deri në atë shkallë kur mund ta mbulojë marrëdhënien e vërtetë të atmosferës, ka zgjedhur një retorikë tepër të rafinuar. Snobi gjithmonë kërkon mbështetje nga vende të ndryshme, kërkon referenca nga i sjell argumentet, sepse ekzistencën e vet ia ka borxh imitimit të atyre që i konsideron për më të lartë se vetja. Dandy në klasën e vet, në rrugën në të cilën ec, është orientuar të jetë më i përsosuri. Dandy është origjinal, ndërsa snobi veten mund ta prezentojë për origjinal derisa t'i zbulohet thelbi. Trimëria për të arritur suksesin duke refuzuar mbështetjen në strukturën intelektuale të bazuar në mendim dhe kërkimi i sinqeritetit në "skajin" më të largët duke ndjerë pamjaftueshmërinë e rrugëve të pranuarra të sqarimit në fushë të artit janë punë të dandy-t. Puna e snobit është propaganda për legalizimin e iluzionit. Për pasojë, përderisa dandy bëhet i njohur ose prezentohet në saje të punës së vet, snobi për njoftimin e vetes ndjen nevojë për një organizatë të tërë. Shprehja e të thënurës me shembuj konkretë është e vështirë por jo edhe e pamundshme. Vështirësia qëndron në faktin se snobët në periudhat kohore kur kanë jetuar, së bashku me poteren që e kanë krijuar, janë zhdukur pa lënë gjurmë e zë, si dhe se nga dandy-t deri te ne kanë gjetur mundësi të arrijnë vetëm

individualitete si Laforgue dhe Heidegger. Por një kërkim botimesh do të nxirrte në shesh të vërtetën se disa snobë kohë pas kohe kanë jetuar në periudha të ndritshme.

Nuk është rëndë të parashikohet se në konstruktin kulturor të kohës pas Tanzimat-it snobizmi ka përfshirë një vend më të madh sesa në kuadër të shoqërisë tradicionale; deri sot kemi arritur nga "Şık"-ët (elegantët), Efruz Bey-ët...!

Struktura jonë kulturore në kuadër të procesit të westernizimit, në të cilën vazhdimisht kanë gjetur vend edhe snobët edhe dandy-t, deri në fund të Luftës së Dytë Botërore bart një rëndomtësi relative. Nga njëra anë shoqëritë e Periudhës së Industrializimit dhe produktiviteti i tyre në çdo lëmi, nga ana tjetër Turqia, e cila bën përpjekje për ta arritur fuqinë e tyre dhe e cila lëkundet duke zhvilluar debate rreth metodës së këtyre përpjekjeve.

Përgjatë tërë kësaj periudhe, për Turqinë vlen shprehja "intelektuali i vendit në zhvillim e sipër". Intelektuali i vendit në zhvillim e sipër, nga pandani i tij perëndimor dallohet jo në cilësi por në shkallë. Detyra e të dyve është "përpjekja për t'i qytetëruar të tjerët". Në këtë peridhë kohore, dallimet ndërmjet shoqërive kuptohen si dallime në shkallë. Gjërat që në Periudhën e Industrializimit i kanë preokupuar edhe "qendrat" edhe "filialet" perëndimore, kanë qenë paragjykimet pozitiviste dhe hesaposjet e përhershme me këto paragjykime.

Vendi i posaçëm që e kanë zënë intelektualët turq në periudhën e ndryshimit kulturor të këtij vendi i ka gjykuar ata me njëfarë serioziteti. Pa marrë parasysh polet politike ku kanë zënë vend intelektualët e Tanzimatit, Kushtetutshmërisë (Meşrûtiyet) dhe fazës së hershme të Republikës (turke), me lehtësi vërejmë se veprimtaritë e tyre prej intelektual i kanë zhvilluar në lidhshmëri të fortë me politikën dhe duke "luajtur kumar me jetën". Është vështirë të kuptohet rezultati i mendimit në botën reale duke kërkuar suksesin përgjatë kësaj periudhe të gjatë dhe refleksioni në thelbin tjetër të veprimtarisë duke kërkuar sinqeritetin në art. Në letërsinë dhe jetën mendimore turke, tendencat e ndryshme dhe të kundërta midis vete jetojnë me ekuivalentet e veta shoqërore. Në një ambient të tillë, kultura snobiste ka mundur të gjejë hapësirë gjallërimi vetëm në sferat e jetës së përditshme, respektivisht nuk ka mundur t'i gjejë vetes vend të përshtatshëm në botën e mendimit dhe artit.

Transformacioni i madh pas Luftës së Dytë Botërore, d.m.th. revolucioni shkencoroteknologjik, ka ndikuar mbi Turqinë aq thellë sa ka ndikuar edhe mbi pjesën tjetër të botës. Intelektuali turk, i cili e ka mbajtur mbi shpinën e vet peshën më të rëndë të transformacionit kulturor, i cili nuk e ka shkëputur dhe asnjëherë nuk është përballur me kushtet e shkëputjes së udhëheqjes shtetërore, arsimit dhe sistemit ekonomik nga përgjegjësia që të njëjtave u atribuohet në poezi, teatër dhe roman, veçmë ka qenë i detyruar t'i kërkojë dhe t'i gjejë një përkufizim të ri vetes. Struktura e re shoqërore ishte "paradoksale" për intelektualin turk: me kushtëzimin e formës "sektori shtetëror, ekonomia dhe mass mediumet mund të udhëhiqen vetëm nga njerëz të 'ditur', 'ekspertë', në sektorët e cekur u zhdukën kushtet në të cilat njerëzit që kishin ruajtur identitetin e vet si "intelektualë" do të mund ta ndjenin veten të lirë dhe të korrnin suksese. Marrja e poezisë një formë "të çuditshme", mosuksesi i përrallëshkruesit në ujërat e gazetarisë, rastisin pikërisht në këto kohë. Ky zhvillim, pa e ndryshuar kafen por duke u ndërlëkuar edhe më, vazhdon deri sot.

Në ditët që po i jetojmë, marrëdhëniet ndërshoqërore në sferën e informacionit dhe dijes janë duke u kondensuar me një shpejtësi marramendëse. Përkundër kësaj (dhe si kusht i kësaj) intelektualët, lidhur me shoqëritë e veta, po shprehin pëlqimin e tyre me një arritje diturie të zhveshur e të pabazë. Sot veçmë në botën kulturore vendin e ndarjes "qendra"

dhe "filiali" e ka zënë ndarja "metropoli" dhe "mëhalla periferike". Tash më nuk ekziston intelektual i vendit në zhvillim e sipër, por vendi i intelektualëve në zhvillim e sipër. Nga njëra anë, njeriu i vendit të përparuar teknologjikisht është kah i përjeton çështjet e njëjta me ato të qytetarëve të vendeve që dominohen nga teknologjia e njëjtë, e nga ana tjetër, pëlqimi me zemër e shpirt e josipërfaqësor i karakteristikave të sjella nga historia dhe i atyre të vendit agrarogjen na del përpara si një domosdoshmëri për të mbetur njeri.

Është e pamundur të mos vërehet se galimatiasi që po përjetohet, sa snobëve aq edhe ekstremistëve u ka dhënë hapësirë të gjerë të qenësimit, kurse dandy-t janë të gjykuar në memeci para koalicionit snobët-ekstremistët. Gjëja që duhet ta bëjnë ata që në shekullin tonë përcaktues të vetëm në art e konsiderojnë motivin e autenticitetit (si në Turqi ashtu edhe gjithkund) është t'i përdorin aftësitë e gjykimit dhe haptazi të shprehin se nuk e shohin të vlefshme t'i kuptojnë personat që mundohen të jetojnë me qiranë e të qenët doktrinar, si dhe ata që pa prezentuar ndonjë kapëse të testueshme gjatë vlerësimit të vetes, rrahin gjoks për superioritet. Pa marrë parasysh dimensionet e efekteve komplekse dhe destruktive të shoqërisë shkencore-teknologjike, heronjtë e dramës Përralla jonë nga bregu lindor janë 'zhetët' dhe 'peshkaqenët' e jo snobët që edhe pse jetojnë në mëhallën tonë, duke u fshehur në dyqanin e akulloreshitësit imagjinojnë farefisë pasanikë në Boston ose në Rivierën e Detit të Zi.*

PËRFYTYRIMET TONA JANË MURE

Në shekullin tonë, - kur qarkullimi i lajmeve është shumë i shpejtë, kur vërshimi i "informacioneve" kohë pas kohe na zvarrit, e kohë pas kohe na e tërheqë dhe na e grabit nga rrethi jonë atë që në të vërtetë duam ta dimë, - vërejmë se ndërmjet dy njerëzve shumë rëndë arrihet njëfarë komunikimi që do t'i kënaqte të dy palët. Nuk mund e të mos e themi se, në këtë rrëke të informacioneve nga ne merren komunikata të shumta të cilat i "shprehim me gjuhë", por ndërkohë zihet rruga që na shpie kah dituritë të cilat kemi nevojë t'i "vërtetojmë me zemër". Koha për të cilën Arthur Rimbaud flet 105 vjet më parë, me sa duket ende nuk ka ardhur:

Le të vijë, le të vijë,
koha kur do t'ia dorëzojmë veten pasionit.

Në të gjitha këto periudha të kaluara, njerëzit kanë ngritur nisma e veprime pasionuese si revolucione, luftëra, kanë përjetuar kriza të llojllojshme. Por ç'e do që pasioni i përjetuar ka qenë me karakter të nervozizmit, tensionimit, të mbyllurit në vete dhe izolimit. Derisa kontaktet në rrugën kah solidariteti, vëllazërimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë kanë mbetur tepër josistematike dhe sipërfaqësore, armiqësitë, dhe urrejtjet në mënyrë rapide i kanë shtuar distancat midis njerëzve. Nuk u habitemi armiqësive ndërmjet njerëzve të të njëjtit komb, të së njëjtës klasë dhe ideologji por lidhjeve të pashkëputshme, pasionit që e vërejmë në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Urrejtja dhe armiqësia që duken në raportet ndërnjerëzore nuk janë të përmasave sipërore, nuk kanë arritur nivelin e seriozitetit. Njeriu i kohës sonë interesimin sipërfaqësor që e tregon në të "hapurit" ndaj tjetrit, gjatë "mbylljes" e shndërron në urrejtje. Me sa duket shkak për të gjithë njerëzit në raportet me të tjerët mbeten "të ngrirë" qëndron në të vërtetë se janë të lënë pas dore.

Ndër synimet kryesore të rrjetit informativ dominant në përmasa globale janë: zbatimja e njeriut, krijimi i preokupimeve për të dhe largimi i mërzisë së jetës. Të qenët i vetëdijshëm për ekzistencën e mërzisë dhe depresionit, në një aspekt e ka kuptimin e fillimit të lundrimit në ujërat e mendimit dhe kërkimit të kapëseve autentike të jetës. Në botën e ditëve tona, mërzia tërësisht është burgosur në suaza të individuale. Askush nuk thotë se në të vërtetë janë mekanizmat e ndryshme ato që vjellin depresion dhe mërzinë. Elementi i cili me të vërtetë do të na shpëtojë nga ky shekull i mërzitshëm është njeriu. Në shekullin tonë lodrat fëmijërore na ngushëllojnë kurse njerëzit na mërzisin. "Njeri i mërzitshëm,-thotë Annie Vivanti, -është ai individ që kur ne duam t'i flasim për veten tonë, ai na flet për vetveten". Ne, nën rrethimin e shekullit modern përvëlohem nga ndjenja e të biseduarit për vetveten, por para nesh na del një njeri i cili dridhet nga dhimbja e njëjtë. Se një njeri i caktuar është i mërzitshëm kuptojmë atëherë kur paralel i hasim dy dukuri:

1. Pala dëgjuese dëshiron të flasë për veten ose më së paku dëshiron që të bëhet muhabet për të.

2. Pala folëse (përkundër asaj që pret dëgjuesi) flet për vetveten.

Për ta evituar raportin e mërzitshëm midis njerëzve duhet që në rastin kur jemi duke e dëgjuar tjetrin të mos mundohemi ta nxjerrim në plan të parë veten; nëse na është dhënë rasti të flasim duhet të diskutojmë duke mos e nxjerrur në skenë vetveten. Por, tash na del përpara kjo pyetje: Si mundemi pa ndjerë mërzinë t'i lexojmë jetëshkrimet e disa shkrimtarëve ose artistëve? Motivi që na nxit për një gjë të këtillë është krahasimi

ndërmjet gjendjes së autorit të veprës përkatëse me gjendjen tonë. Nëse njeriu të cilin jemi duke e dëgjuar nuk është i mërztishëm, shkakun për këtë duhet kërkuar në krijimin e lidhshmërisë ndërmjet jetës së prezentuar para syve tonë me atë që ne e mendojmë rreth vetes sonë. Edhe më e rëndësishme është e vërteta se neve na duket edhe më interesant fakti se si njeriu që e prezenton jetën e vet do të ballafaqohet me problemet që ne i kemi përjetuar në përmasa tjera. Tekefundit çdo jetëshkrim nuk është tërheqës për ne. Individit, jetën e të cilit jemi duke e ndjekur, sa më tepër që të jetë "unë", ose "ne" aq është më larg të qenët i mërztishëm.

Gjatë jetës së njeriut, faza kur më së shumti ndjehet mërzia janë vitet e rinisë. Njerëzit që sapo e kanë kaluar fazën e fëmijërisë dhe të cilët ende nuk i kanë përcaktuar kufijtë e rrugës të cilës do të shkojnë, shumë lehtë mërztiten dhe shumë lehtë tjetrin e gjejnë për të mërztishëm. Në këtë fazë të jetës, kur njeriu më së shumti dëshiron të bëhet fjalë për të, bëhen përpjekje në drejtim të arritjes së sukseseve të ndryshme. Në mesin e tyre, meqë në fazën e rinisë problemi i seksit zë një vend të veçantë, preokupim kryesor i jetës shpirtërore sa vetëpëlqimi (narcisoiditeti) është edhe bërja e vetes i pëlqyeshëm për të tjerët. Në realizimin e ndërhyrjeve të rëndësishme në fazën rinore në lëmin e artit dhe shkencës luajnë rol shfaqja e aftësive, karakteristikave, përpjekjet për t'u treguar i ndryshëm dhe superior ndaj të tjerëve.

Njerëzit e periudhës së përgatitjes (rinisë), të cilët më së tepërmi mërztiten, të cilët jetën e shohin të mërztishme, "i madhërojnë" të gjitha llojet e kallëpeve ideologjike. Njerëzit e rinj, meqë janë të prirë që veten ta shohin në qendër të botës edhe mendimet dhe idetë e veta mundohen t'i pozicionojnë në këtë qendër dhe dëshirojnë që çdo njeri të njihet me idetë e tyre nga ajo pikë. Çdo gjë që largon nga ideja se është në qendër të botës, njeriut të mërztitur i shkakton dhimbje. Mërzia, në veçanti në vitet e rinisë, është një ndjenjë 'narcisoide'.

Pa marrë parasysh se a jemi të rinj ose jo, gjetja e rrugës së marrëveshjes ndërnjerëzore dhe arritja e vetëdijes se vështirësia më e madhe në ruajtjen e kësaj gjendjeje janë dobësitë e personalitetit tonë, paraqet një hap të rëndësishëm drejt kapërcimit të gjendjes së vështirë. Duhet theksuar se në të shumtën e rasteve nëse s'mund ta nxjerrim në plan të parë vetveten, bartim pasionin e nxjerrjes në plan të parë të përfytyrimeve të derivuara nga vetvetja. Madje, ndodh që shndërrimin e këtyre përfytyrimeve në një personalitet e konsiderojmë pretekst të mburrjes. Deprimohemi tepër nëse dikush flet pa i marrë parasysh përfytyrimet tona. Veçanërisht nëse ai person na flet për përfytyrimet e veta, e gjejmë ose e konsiderojmë tepër të bezdisshëm. Por, ç'duhet bërë? A thua për hir të kuptimit të njerëzve do të heqim dorë nga përfytyrimet tona? Ose, për ta sqaruar vetveten tonë do të presim që personi para nesh të heq dorë nga të tija? Pandeh se duhet të sillemi ngjashëm si në rastin kur lexojmë ndonjë jetëshkrim: Krahasimi i përfytyrimeve tona me ato të të tjerëve. Të kuptuarit e përfytyrimeve të tjetrit që janë të ngjashme me tonat, zbulimi i aspekteve të përfytyrimeve tona që i takojnë tjetrit dhe krijimi i një raporti. Domethënë, është e domosdoshme që përfytyrimet tona të mos jenë mur që e pengon kuptimin e të thënurës, por një gungë ose nyje e butë dhe kollaj e zgjidhshme. Në të kundërtën, nuk do të mbetemi vetëm person i mërztitur por gjithashtu nuk do të mund të shpëtojmë nga të qenët i mërztishëm edhe për të tjerët.

Një thënie e La Rochefoucauld-it e shpjegon këtë subjekt nga një kënd tjetër: "Nëse nuk do të kishim fare krenari nuk do të ankoheshim as nga krenaria e të tjerëve". Në të shumtën e rasteve nevríkosemi ngase sjelljet e të tjerëve që nuk i pëlqejmë dhe nuk i aprovojmë janë të barasvlershme me sjelljet tona të papëlqyeshme. Kritikata e ndërsjella në raportin fëmija - prindi janë fryt i të vërtetës se të dy palët te tjetri e shohin refleksionin e përfytyrimit

lidhur me vetveten. Realiteti i individëve që gjërat "pronë e tjetrit" i bien në pozitë të një çështjeje mendore, zbulon realitetin tjetër se vetë ata mbërthehen nga brenga se si t'i përvetësojnë të njëjtat. Njerëzit e kritikojnë jetën brenda shpresave të veta. Të metat që i shohim te të tjerët, në të shumtën e rasteve janë mangësitë tona.

Duke shkruar mundohem që t'i shpëtoj ngrirjes në përfytyrimet që i kam në kokë. Padobishmëria e shkrimeve të mia qëndron në mundësinë për braktisjen e të njëjtave. Kur gishti e tregon hënën, nuk duhet shikuar gishtin por hënën.

DUKE PRITUR DIJETARINË

Në fëmijëri dhe vitet e adoleshencës sime, ndoshta sikurse edhe shumë të tjerë, ndjeja një pasion të madh për ta perceptuar vetveten, për t'ia treguar vetes vetveten, për ta shpalosur lidhjen time me botën. Nuk dua të pohoj se këto ndjenja kanë lidhje me skepsën metodike të Descartes-it. Para së gjithash as qenien time e as ekzistencën e botës së jashtme nuk i njihja si "çështje". Lirisht mund të pohoj se tekstet filozofike lidhur me këto çështje nuk më tërhiqnin fare. Sipas meje, çështjeve të këtilla ende nuk u kishte ardhë radha. Tek unë, në plan të parë ishte çështja e pozicionit tim në këtë botë. Nuk arrija dot t'u gjej themel ose mbështetje të shëndoshë veprave të mia; mundësia dhe pamundësia e çdo gjëje më dukeshin si të barasvlershme. Krahas kësaj jetoja, nuk e bëja x veprën, por y-në. Në mendjem time nuk ekzistonte ndonjë kallëp ose model ku në të ardhmen do ta gjeja veten. Pjesëmarrja në botë më dukej diçka që më dispononte, por nuk e dija se ç'jam dhe kush do të bëhem në të ardhmen. Përsëri kur e forcoja lidhjen me botën vija në përfundim se mundja ta observoj një fushë më të gjerë. Kjo më satisfaksiononte.

Në gusht të vitit 1968 rusët e okupuan Çekoslllovakinë e atëhershme. Kjo ngjarje më shpuri në kthjelltësinë se më nuk do ta humb edhe një herë mendjen rreth çështjes së thelbit të relacionit jeta ime - bota. Unë në këtë botë isha një dëshmitar, një shahid. Të gjitha të bëmat e mia së bashku me dëshmitarinë kishin një kuptim. Gjithçka mund të bëhej ose jo, por vendin tim në botë e përcaktonte dituria ime në fushë të asaj dëshmitar i së cilës isha. A thua dëshmitaria ishte një qëndrim pasiv përballë kësaj bote? Jo. Sikur të isha në Pragë dhe sikur të zija vend në anën e rusëve, do të isha dëshmitar i një të vërtete, e sikur të zija vend në anën e çekëve dhe sllovakëve, do të isha dëshmitar i një të vërtete tjetër. Por ç'e do që në atë kohë isha në Turqi, isha dëshmitar i një të vërtete lidhur me të qenët në Turqi. Dua të theksoj se kjo specifikë ka shkaktuar një kristalizim të pashmangshëm në mendjen time. Çështja "ku jam" ishte e lidhur me atë "kush jam". Okupimi i Çekoslllovakisë nga rusët mua nuk ma tregoi vetëm fenomenin se në këtë botë jam një dëshmitar, por edhe atë se nuk mjafton vetëm të jeshë dëshmitar i fenomenit të caktuar, por paralel me këtë duhet që të jeshë dëshmitar edhe i të drejtës dhe atij që është me të vërtetën. Por nuk isha i përgatitur që ta ekzaminoj këtë subjekt. Fjalët e shkruara në një pankartë të lirisë në Çekoslllovakinë e atyre ditëve, më dukeshin sikur dilnin nga goja ime:

Asgjë nuk mësuam
asgjë nuk dimë,
asgjë nuk kuptojmë,
asgjë nuk shesim,
nuk ndihmojmë,
nuk tradhtojmë,
dhe, nuk do të harrojmë.

Vendimi i fundit në këtë pankartë, "nuk do të harrojmë", më dukej si një gur themeltar në jetën e njeriut. Sado që dëshmitaria e sqaron thelbin e ekzistencës sime në këtë botë, nëse harroj, dëshmitaria ime i humbë si kuptimin ashtu edhe vlerën e vet. Nuk do të harroj, nuk do të harrojmë. Por vallë, vetëm mosharrimi a ma siguronte mekanizmin që do të më orientonte? Në botë gjendem si një dëshmitar. Të qenët dëshmitar mund ta vazhdoj vijës së drejtë vetëm duke mos harruar. Por, hapërimi im në një drejtim të caktuar, qoftë ai i drejtë ose i shtrembër, është fryt i raportit (tim) me njerëzit. Si duhet të sillem, ç'qëndrim duhet të marr karshi njerëzve që t'i mbetem besnik thelbit tim (karakterit tim) dhe të

përparoj në drejtim të veprës së drejtë e të qëlluar? Përgjigjen në këtë pyetje vite më vonë e gjeta në afirmacionin e Thomas S. Szasz-it:

"Njeriu i marrë as s'falë e as s'harron; njeriu naiv së pari fal e më vonë harron; dijetari fal por kurrë nuk harron".

Ja pra, këto fjalë mund të na ndihmojnë që të vijmë në vete, që të biem në binarë, sepse në Turqinë e ditëve tona njerëzit shpeshherë sillen ose si i marri ose si naivi dhe, kampizimi politik në skenën shoqërore të këtij vendi lind nga pëlqimi ynë permanent në formë të alternacionit të sjelljeve të të marrëve dhe naivëve. Por në kuadër të aventurës sonë të oksidentalizimit (westernizimit), mospëlqimi ynë i qëndrimit të një dijetari ose personi të urtë, gjithmonë na ka braktisur para problemeve me kokën tonë të turbulluar dhe në një gjendje të ngrirë.

Është evidente që individi që nuk fal dhe nuk harron gjithmonë e ndjen veten në pozitë të auto-apologjisë*. Mosfalja e këtij individi buron nga bindja se përherë është në shënjestër të sulmeve, kurse mosharrimi nga përpjekja e tij për ta mbajtur në këmbë forcën e vet mbrojtëse. Nuk fal sepse ekzistencën e vet e lidhë me mosfaljen. Në këmbë qëndron vetëm duke i evokuar kujtimet. Nuk harron sepse mosfalja e tij është e mundshme vetëm me mosharrimin. Njeriu që veten nuk e ndjen të fortë deri në atë shkallë që ta falë vetveten, më në fund mosfaljen mund ta sjellë në gjendje kur ajo (mosfalja) do të jetë pjesë e karakterit të tij. Mosfalja bëhet pjesë e karakterit, natyrës dhe personalitetit të tij. Nuk fal me qëllim të mbrojtjes së personalitetit dhe realizimit të kërkesave të natyrës së vet. Mosharrimi gjithmonë është rezervë e të qenët mosfalës. Të kujtuarit, vetëpërvete nuk paraqet një vlerë. I marri, mosharrimin nuk mund ta bëjë mbështetës të shëndoshë të dëshmitarisë së tij.

Personi naiv që fal e më vonë harron, si rrjedhojë e pasivitetit, i lëshon duarsh penjtë e rrjedhës së jetës së vet. Falja e tij më tepër buron nga mospërfillja ose indiferenca sesa zemërmirësia. Ndoshta frikohet dhe nuk merr guxim t'i evokojë kujtimet. Duket sikur që nga fillimi, që më parë e ka pranuar harrimin. Fal sepse nuk ka fuqi të rezistojë. Harron sepse nuk ka themele të shëndosha të faljes. Për naivin mosfalja është një specifikë larg të qenët e kuptueshme. Mund të themi se te ky njeri nuk ekziston një reagim që do të korrespondojë me mosfaljen. Ky njeri nuk mundet që të mos harrojë sepse nuk ka njohuri për dobinë e përkujtimet. Naivin nuk mund ta konsiderojmë për dëshmitar.

Raporti i dijetarit - që falë por në asnjë mënyrë nuk harron - me jetën, shfaq baraspeshën për të cilën ndjejmë nevojë. Ai e ka pajisur veten. Është i pajisur me dituri dhe pjekuri deri në atë nivel kur mund të falë. Kjo pajisje i ndihmon atij që aspak mos të harrojë. Fal, sepse ekzistencën e vet në këtë botë nuk e lidhë me mbajtjen gjallë të së keqes që i është bërë.

Njohja e gabimit personal si dhe e gabimeve të të tjerëve është e mundshme vetëm me të kuptuarit e elementeve që janë shkaktarë të gabimeve në fjalë. Kësisoj mund të thuhet se vetëm ata që kuptojnë mund të falin. Njeriu, kur nuk falë, vazhdimisht sillet rreth asaj të keqeje dhe nuk shënon përparim në pikën e fuqisë së të kuptuarit. Pos kësaj, nëse nuk falë do të bie në pozitën e mbrojtësit të një strukture që e ka humbur përmbajtjen, një strukture të ngrirë dhe statike sepse, pas përkufizimit dhe kristalizimit të gabimit, njeriu ballafaqohet me strukturën që nuk lëvizet nga vendi në të cilin gjendet. Dijetari fal. Kjo sjellje e tij nuk vjen nga nënshtrimi i tij para gabimit ose nga tërheqja prapa para saj, por ngase ajo është punë të cilën ai duhet kryer. Ai është i vetëdijshëm si për dobitë e faljes ashtu edhe për të vërtetën se mosfalja te njeriu shkakton një ashpërsim. I dituri është fleksibil dhe vital deri në atë pikë saqë fal. Mosfalja sjell shabllonizimin në korniza të

kujtimit të së kaluarës. Fuqia e faljes është shenjë se individi përkatës është zemërmirë, është siguresë e sjelljeve dhe veprave kreative, konstruktive që mund të vijnë pas faljes. Njeriu i ditur dhe i urtë falë por nuk harron, sepse nëse pas faljes vijon harrimi humbet domethënia e të parës. Nëse harrohet se gabimi është gabim, falja e humbë vlerën. Nëse harroni pasi të falni, i lëshoni duarsh penjtë. Mosharrimi duhet të jetë njëri nga fitimet tuaja. Armiku juaj që ka rënë në gabim duhet ta dijë se nuk mund të manipulojë si të dëshirojë me ju.

Faktori që do t'ju vërë në binarë të shëndoshë është gjendja ose dëshmitaria në botë. Ju bëheni të kuptimtë duke qenë dëshmitar, duke dëshmuar, e jo duke i mbyllur sytë para njerëzve dhe gjendjeve me të cilat ballafaqoheni. Nëse nuk harroni por falni, kjo don të thotë se do të jeni të fuqishëm përballë çdo individi dhe gjendjeje. Falja do t'ju bëjë vital para armikut tuaj. Sado që falja të diturin dhe të urtin e bën të butë, fleksibil dhe të kuptueshëm, mosharrimi e bën vital dhe të shëndoshë.

I marri, me gendjen e vet prej mosfalësi dhe mosharruesi, është i ashpër dhe i vrazhdë. Thyen ose thyhet; copëton ose copëtohet. Naivi me sjelljen e tij prej falësi dhe harruesi është i butë dhe i lehtë. Nuk thyen por thyhet; nuk copëton por copëtohet. Kurse i dituri dhe i urti me sjelljen e tij prej falësi por mosharruesi është fleksibil dhe vital. As s'thyen as s'copëton; as s'copëton as s'copëtohet.

I marri është si guri: nëse bie në ujë fundoset. Naivi është si sheqeri: nëse bie në ujë shkrihet. I dituri dhe i urti është si vaji: Nëse bjen në ujë noton.

AJO TË CILËN NJERIU E ZGJODHI TA HARROJË

The Dry Salvages*

Nuk kuptoj shumë nga zotat: por kujtoj se lumi

Është një zot i fuqishëm e i murmë - i hidhëruar, i ashpër dhe i revoltuar

Deri diku durimtar, së pari njihej si kufi

I dobishëm ishte, si një rrugë afarizmi nuk jepte siguri;

Pastaj para arkitektëve të urave vetëm një çështje u bë.

Posa u zgjidh çështja, zoti i murmë u harrua

Banorët e qyteteve - ai prap, aman mbeti i papërkulshëm, gjithmonë,

Nuk i la stinët e veta, mllëfin; destruktiv, përkujtues

I asaj që njerëzit zgjodhën ta harrojnë

E ka humbur vendin n'zemrat dhe sytë e adhuruesve të makinës, por pret, mbikëqyr dhe pret.

Thomas Stern Eliot

Në këtë botë plastike në të cilën jetojmë është e rëndësishme që lumin ta shohim si "një fenomen që njeriut ia përkujton atë të cilën ai e zgjodhi ta harrojë." Janë dukuritë që e vazhdojnë ekzistencën ashtu siç janë krijuar përsëpari, apo thënë më mirë, të cilat manifestohen sikur krijohen në çdo moment, ato që ofrojnë mundësinë për të perceptuar diç nga lidhshmëria ndërmjet ezel-it dhe ebed-it*, që madje edhe duke pëshpëritur në disa pjesë të shpirtit dhe trupit tonë na japin mundësinë për t'i përkujtuar cilësitë tona që flejnë e pushojnë.

Le të ndalemi një çik. Në një paragraf të vetëm mbërthyem shumë fjalë rreth të cilave nëse nuk arrijmë marrëveshje nuk do të kuptojmë se ç'është thënë. Krijimi, ezeli dhe ebedi, shpirti dhe trupi etj..., zotimi për t'u dhënë kuptim këtyre fjalëve në dimensionin horizontal dhe vertikal, do të shkaktonte që të njëjtat të merrnin kuptime shumë të ndryshme nga e synuara përmes shkrimeve të kësaj veprë. Tash për tash, shumë fjalëve dhe koncepteve jemi të detyruar t'u japim domethënie sipas asaj që ato na asocojnë në jetën e përditshme. Por le të theksojmë se nëse nuk sqarojmë se ç'domethënie u kemi dhënë fjalëve "të harrosh dhe të përkujtosh", të thënat tona do të mbeten mjaft të mbyllura. Këtu nuk jemi duke bërë fjalë për qëndrimin platonik i cili parasheh përkujtimin e idea-ve nga një botë tjetër. Duke lënë mënjanë rëndësinë dhe vlerën e këtyre botëkuptimeve, jam duke folur për përkujtimin e karakterit të gjërave të kësaj bote që janë subjekt i perceptimit tonë. Si subjekt kam parasysh çështjet që lindin dhe do të lindin nga përkujtimi ose harrimi i kushteve dhe rrethanave të qenësisë së gjërave me të cilat kontaktojmë në sipërfaqe të tokës, nga përkujtimi ose harrimi i thelbit të marrëdhënieve tona me to.

Çdo krijesë ka lidhur kontratë (ahd) me Krijuesin, d.m.th. me All-llahun (xh.sh.). Nga këto krijesa vetëm njeriu është ai që bart cilësinë e harrimit të kësaj kontrate. Biri i Ademit (njeriu) kur kontakton me gjërat ose objektet e ndryshme ka mundësi që ta përkujtojë Zotin. Natyrisht që shfrytëzimi i kësaj mundësie varet nga tendencat ose prirjet tona.

A thua te ne ekziston prirja për të përkujtuar ose për të harruar? Nëse sjelljet tona përballë gjërave jashtë njeriut dhe karshi njeriut i programojmë duke e mbajtur në llogari kontratën tonë me Zotin, do të thotë se jemi të vendosur në përkujtim, e nëse të njëjtën e lëmë pas shpine, do të thotë se e kemi zgjedhur harrimin.

Qytetërimi perëndimor, i cili sot na ka marrë nën flatrat e ndikimit të vet, është një qytetërim i harrimit. Kjo, për arsye sepse u lind dhe u zhvillua në duart e njerëzve të cilët duke komunikuar me natyrën, nuk kanë ditur se e njëjta është e lidhur me ta me një lidhëse thelbësore. Evropianët, me këtë harrueshmëri të qëllimtë dhe të vendosur, aq i kanë besuar vetes, aq të fortë e kanë pandehur veten saqë u është shkatërruar mbamendja. Nuk mbetën vetëm me kaq por edhe popujt që nuk kishin harruar plotësisht, i detyruan të pranojnë se ç'dobi të mëdha lindin nga harresa.

Të harrosh. Kjo fjalë të mjerëve të qytetërimit që jemi duke e jetuar u jep një sqarim që s'mund të përçmohet. Njerëzit, themelet e këtij qytetërimi i vunë duke i harruar kërkesat e dijes së përcjellë përmes pejgamberëve. Domethënë, përfitimet e aprovimeve mendore dhe mekanizmave të veta logjike i konsideruan superiore ndaj përkujtimeve që ua bënë atyre gjithësia që krijohet në mënyrë permanente. E sistematizuan pandehmën. Me harrimin e asaj që njerëzve u solli risaleti (pejgamberia), iu rrit nami një qytetërimi që e mbulon të vërtetën. Këtu është radha të përmendim se kuptimi themelor i fjalës kufr është "mbulim". Njeriu kur ndërmeret ndonjë nismë për ta mbuluar të vërtetën e thelbit të vet dhe krijimit të gjërave në përgjithësi, hapëron drejt kufrit. Përpjekja për të mbuluar, kristalizohet në dobësinë tonë para prirejeve të forcës së quajtur neft (ego, epsh) e cila mundohet të na mbërthejë brenda prangave të pesë perceptoreve. Kur e lëmë pas dore përkujtimin, përnjëherë i absolutizojmë rregullat që i kemi vënë vetë dhe qëndrimin tonë arbitrar. Kësisoj zhytëmi në rrethin psikologjik të quajtur "besim i gabuar" (besëtytni). Nga kjo pikëpamje nuk ekziston dallim i madh ndërmjet shpresës sonë nga lecka e lidhur në tyrbe dhe shpresës nga shkenca bashkëkohore. Në të dy rastet, duke i vizatuar kufijtë e strukturës fizike dhe morale të njeriut, duke i absolutizuar ato, domethënë duke e bërë këtë përkufizim sipas dëshirës sonë - kërkojmë një lidhshmëri me botën.

Të harrosh. Mund të thuhet se kjo është rruga më e shkurtër deri te mosbesimi (kufri). E mbuloni fuqinë e mendjes e cila ju afron deri te e vërteta. Harroni se keni bërë një marrëveshje me Krijuesin, se çdo krijesë është e lidhur me një marrëveshje të këtillë. Refuzoni se njeriu para vetes ka disa shenja që e shpjen deri te çështjet themelore. Për ju, çështjet lidhur me thelbin tuaj, me urtësinë e ekzistencës suaj veçmë e kanë humbur vlerën; vendin e tyre e kanë zënë çështjet lidhur me aparençën e gjërave që lehtë ndryshohen. Tokën keni filluar ta shikoni pavarur dhe të shkëputur nga njohuria dhe ndjenja se është elementi themelor nga i cili jeni krijuar. Për këtë arsye ndaj saj nuk ndjeni respekt, dashuri dhe vëllazëri. Ju, tashmë jeni të preokupuar me atë se si mund ta ndani atë, sa prodhime mund të merren prej saj dhe cili pallat ose ç'fabrikë ose uzinë mund të ndërtohet mbi të. Kështu pra, keni harruar se toka është tokë, se është e krijuar, dhe shkurt, se ajo është ekzistente. Pse? Sepse keni dashur që cilësitë e saj që juve ju shkojnë për shtati t'ia zënë vendin të vërtetës së ekzistencës së saj. Ta harrosh tokën, don të thotë të harrosh se ajo ka një të vërtetë, domethënë, se ajo ka një kontratë me të Madhin Zot. Në kuadër të kësaj injorance, toka është vetëm një send ose objekt, ekziston rastësisht dhe rastësisht mund të zhduket, shkatërrohet. Personi që ka një botëkuptim të këtillë, njeriun dhe vetveten do ta shikojë në po atë trajtë. Kur do të dëshironi të arrini në një gjendje më të mirë do të bëni përpjekje vetëm për të përvetësuar vlera të matshme. Do të dëshironi që veten ta pajisni me pasuri që janë objekt i shitblerjes (i transaksioneve të ndryshme). Kthimi kah vlerat e thelbit tuaj më nuk do të jetë një specifikë që duhet vënë mendjen sepse keni harruar se thelbi juaj përbën kontratën. Në këtë mënyrë ju as që dini se ekziston një kontratë.

Në kuadër të këtij harrimi, ju nuk do të keni sukses t'i shikoni dhe shihni mjegullat. Ndoshata zotëroni një mendje e cila është turbulluar me një raport meteorologjik, madje

një mendje të mbështjellur e të mbuluar. Vallë, e përkujtoni të vërtetën se pikat e ujit që bien mbi drunjtë janë mëshirë? Nëse ia arrini kësaj, e pastajmja vjen. Atëherë konsideroheni se jeni orientuar kah zgjedhja e përkujtimit. Mund të arrini të bëni rikonstruim në fushën e kuptimit të elementeve origjinale, themelore të jetës suaj. Shikoni dhe provoni të shihni! Nëse nuk e keni harruar Zotin dhe si pasojë e kësaj, nëse Ai juve nuk ju ka bërë prej atyre që i ka harruar Lartmadhëria e Tij, tanimë do të përkujtoni. Të jeshë nga ata që përkujtojnë, pjesëmarrja jote në mesin e ithtarëve të përkujtimit e përmendjes (ehlu'dh-dhikr) do të të ndryshojë rrënjësisht.

IDENTITETI I NJERIUT

Janë kallëpet ose matrikset që na imponohen ato që i përdorim në të kuptuarit e sistemit që na rrethon, e karakterit tonë personal, thënë me një fjalë, në të kuptuarit e gjithçkaje. Sipas rastit këto matrikse mund të marrin trajtën e një ideologjie, botëkuptimi (weltanschauung, worldwiev-A.P.) ose feje. Çdo gjë të kuptueshme e kuptojmë në vendmbërritjen ku na shpie pikënisja e këtyre sistemeve. Edhe fjalës 'e vërteta' edhe asaj 'njeriu' u japim kuptim që ështrë në pajtim me lejimet e pikënisjes. Sado që të jetë arbitrare pikënisja jonë, sado që të jetë një pikë në të cilën na detyrojnë kushtet, po aq arbitrare do të jenë edhe rezultatet. Njeriu, kjo krijesë inatçore, shumë lehtë dhe shumë shpejt gjen arsye dhe sqarime që atë e nxjerrin të drejtë e të larë. Ne njerëzit nuk vonojmë në të parët e asaj që prej më parë dëshirojmë ta shohim. Së pari japim një vendim se ç'është njeriu dhe në saje të kokëfortësisë sonë njeriun e fusim në një gjendje që është në pajtim me vendimin tonë. Mirëpo, shtrohet pyetja nëse ky njeri ekziston ose jo në realitet? Nëse ekziston ç'është identiteti i tij?

"Në botë nuk ekziston asnjë njeri",-ka thënë Joseph de Maistre. "Gjatë tërë jetës sime kam parë francezë, italianë, rusë etj., por kur vijmë te njeriu, dua të theksoj se me të s'jam takuar fare". Autori i këtyre fjalëve, siç kuptohet, për pikënisje e ka marrë "të qenët pjesëtar i një kombi"; de Maistre është i huaj ndaj botëkuptimit se njeriu është një "lloj" në familjen e gjallesave. Në një farë mënyre dëshiron të nënvizojë se njerëzit mund të njihen me cilësitë e tyre kombëtare. Nëse i zhdukni ato e keni zhdukur njerëzishmërinë e atyre individëve. Natyrisht se kjo është një tezë ose pretendim që mund të shprehet duke qëndruar i kufizuar me një kohë dhe vend të caktuar. Në një botë ku ndarjen e njerëzve në kombe e perceptojmë si diç normale, përdorimi i fjalëve në një stil të këtillë na duket si një mjeshtëri, mënyrën e këtillë të të menduarit e konsiderojmë si të përputhur me ligjet e logjikës. Vendi dhe koha në të cilën jetojmë janë të përshtatshme për të rënë në këtë kurth. Vërtet, po i parashtrojmë pyetje vetes: A ekziston ndonjë njeri që nuk është turk, italian, amerikan, arab, shqiptar...? Ekzistojnë melezët, grupe njerëzish që janë futur në kthetrat e asimilimit brenda një kulture. Por qenia e tyre, nuk mjafton që ta mospërfillim të vërtetën se ndër elementet kryesorë që e përcaktojnë një njeri janë rrethi i tij shoqëror dhe përkatësia një toke. Përkundrazi melezët, këta njerëz që janë goditur nga asimilimi dhe që përfaqësojnë një identitet të ri kulturor, tregojnë se si njeriu "mund të formësohet" me vlerat që i ka marrë ose përfituar.

Edhe pse në veprat shkencore dhe filozofike shpesh na del përpara një njeri abstrakt dhe teorik, në jetën reale nuk hasim në një njeri të këtillë dhe nuk mund ta paramendojmë ekzistencën e një njeriu "teorik". Dorën nuk na e shtrëngon një njeri cilësia globale e të cilit është "njeri", por norvegjezi, spanjulli ose indiani. Fundja, letra që na arrin nuk na vjen nga një njeri por nga zvicerani, japonezi, ugandasi dhe atë që e lexojmë nuk është shkruar në gjuhën e njerëzimit por turqisht, latinisht ose kinezisht.

Identiteti kulturor i njeriut i të qenët pjesëtar i një kombi është një ide që kuptimin e vet e ka fituar brendapërbrenda kornizës së qytetërimit të sotëm, respektivisht brenda qytetërimit borgjez. Të gjithë e dimë se në atmosferën mendore të Mesjetës identitetin kulturor e kanë përcaktuar fetë. Në skenën e katërt të dramës Shenjtorja Jan Dark të Bernard Shaw-it, në mes tjerash i hasim edhe këto fjalë:

"Lordi im, ai është vetëm një francez".

"Francez, thua? Po a edhe burgonjasit, bretonjasit, pikarasit, gaskonjasit kanë filluar që ta quajnë veten francezë, tëpke sikur tanët që e quajnë veten anglezë? Për Francën dhe

Anglinë flasin gjoja se për vatanin e vet. Këto vatane gjoja se qenkan të tyre! Nëse një stil i tillë i të menduarit bëhet modë, mua e ty kushedi se çdo të na bie në kokë?... Veçse mund të të them se këta në thelb janë kundër Krishterimit; madje, Kisha Katolike njih vetëm një të vërtetë e ajo është: vendi i mbretërisë së Jezu Krishtit. Nëse këtë mbretëri e ndanë në kombe, kjo do të thotë se e ke zbritur Krishtin nga fronti i tij. Nëse e zbrit Krishtin nga fronti, ç'është ajo që do ta mbrojë gurmazin tonë nga shpata? Bota do të rrokulliset në baltën e luftës dhe do të shkatërrohet".

Është marri që të qenët tonë njeri ta kuptojmë me një parashtrim arbitrar. Përnjëherë shohim se mendimi perëndimor, edhe kur e përkufizon "njeriun" duke e marrë për kriter përkatësinë kombëtare, edhe kur e përkufizon atë duke i bërë oponencë kësaj përkatësie, gjithmonë flet duke e mbajtur në plan të parë interesin e një klase ose grupi që përfiton nga një sistem i caktuar. Këtë e themi sepse me përpjekjet për futjen e njeriut brenda domethënies ditore, atë e trajton si një fenomen "praktik". Kurse njohuritë tona lidhur me njeriun na çojnë shumë larg fushave praktike. Nga këndvështrimi i raportit tonë me botën, ne presim dobi nga njohuritë tona që zgjerohen në retrospektivë. Përpiqemi që t'i deshifrojmë shkrimet e gozhdave, heksagramet kineze, hieroglifet, sanskritishten..., përmes atyre shkrimeve dhe gjuhëve përpiqemi të krijojmë lidhshmëri me "njerëzit" të cilëve nuk ua kemi shtrënguar dhe nuk do t'ua shtrëngojmë dorën. Këta njerëz, për ne tashmë nuk janë të vlefshëm si sumeras, egjiptas e arianë por me të qenët njeri. Sado që me ngritjen e perdeve të gjuhëve që i kanë përdorë kulturat e vjetra kontaktojmë me identitetet kulturore të tyre, prapëseprapë synimi ynë është që nga e mësuara të nxjerrim mësim në emër të abstraktësisë së quajtur "njerëzi".

Domethënë qenësia jonë si njeri, është edhe tërësi edhe fragment i një aventure të madhe. Tërësia e aventurës lidhet me të vërtetën se jemi të krijuar (krijesa), kurse aventura jonë pjesë ka të bëjë me kushtet në të cilat jemi krijuar. Kur u biem në të dallimeve tona me krijesat dhe njerëzit tjerë, edhe më tepër na rritet mendja si pjesë. Sa më tepër që të rritemi mendsh, aq më tepër na kaplon pandehma se jemi të shkëlqyer. Për pasojë, kjo na i këndell ndjenjat për të qenë pushtetmbajtës në sipërfaqe të tokës, na nxit ndjenjën e të qenët dominantë. Nëse identitetin tonë si njeri e konceptojmë në suaza të raportit pjesa-tërësia, nëse në çdo pikë ku jemi këndellur i kthehemi të vërtetës se jemi të krijuar dhe marrëdhënia jonë është me krijesat, kjo do të thotë se i kemi kapërcyer kategoritë historike, i kemi lënë mbrapa abstraksionet sociologjike, mund të kuptojmë se ndërmjet qiellit dhe tokës domethënia është te njeriu. A thua duhej të them 'mund të përkujtojmë'?

HOMO SAPIENS

Në të gjitha tekstet që formimin e njeriut e shpjegojnë sipas teorisë së evolucionit hasim në sintagmën homo sapiens. Kjo shprehje latine ka kuptimin: njeriu që di dhe njeh. Domethënë botëkuptimi evolucionist paralel me këtë shprehje shfaq tezën se janë zhvilluar llojet etër të njeriut dhe më në fund është arritur në një fazë kur njeriu veçmë ka zotëruar aftësinë e dijes dhe njohjes. Nëse për një çast e lëmë jashtë polemikës sonë mangësinë, plasën dhe ateizmin e teorisë së evolucionit, mund të mendojmë se quajtja e njerëzve të parë homo sapiens është një emërtim që ta kap mendja. Përtej kësaj, emërtimi 'njeri që di' na duket më i kuptimtë se emërtimi homo faber, 'njeri bërës, njeri që punon!' Përderisa përkufizimi i njeriut me të bëmat e veta është më afër objektivizimit (lëndësimit) të tij, përkufizimi i kësaj qenieje me diturinë, njohurinë e saj, tregon se strukturën e saj shpirtërore e shohim më të rëndësishme. Por, ç'e do që në fjalën homo sapiens fshehet një kurth djallëzor: ky kurth ka të bëjë me pretendimin se njeriu zotëron mundësi për ta përkufizuar vetveten.

Biri i Ademit kur e stolisë veten me atributin 'i ditur', përnjëherë e nxjerr në skenë pretendimin se ai e ka gjeneruar kuptimin që i është dhënë tërë gjithësisë. Në të vërtetë, njeriu dallohet nga të gjitha krijesat me njohuritë e veta. Zoti ia ka mësuar Ademit (a.s.) emrat (e gjërave). Melekët me urdhrin e të Lartmadhëruarit i kanë rënë në sexhde njeriut të parë. Por, duhet pasur parasysh se dituria e Ademit është një dituri e marrur dhe njeriut mund t'i sigurojë nder, dinjitet vetëm nëse përdoret në pajtim me burimin nga është marrë. Për pasojë, më e drejtë është që njeriu ta quajë veten 'i mësuar, i pajisur me dituri' se sa 'dijetar, ai që zotëron dituri'. Konsiderimi i njeriut për 'dijetar', sjell me vete idenë se ai e prodhon dhe gjeneron diturinë dhe se me diturinë e vet mund të ekzistojë dhe të krijojë. Kurse e vërteta thotë se njeriu është vetëm përcjellës i diturisë.

Më vjen të them se njeriu i mbërthyer në injorancë është i izoluar përballë sulmit të dijes. Pandehma se burimi i dijes është vetë njeriu nuk është gjë tjetër pos izolim. Me të vërtetë, të gjitha vulgarizimet e bëra në saje të shkencës moderne dhe mjeteve të saj të komunikimit masiv krahas për krahas me hipotezat specifike të Darwin-it, Marx-it dhe Freud-it kanë shkaktuar përsosjen e izolimit vis-à-vis diturisë. Darwin-i krahas të drejtave që ia njohu koincidencës dhe fuqisë së ashpër, ka theksuar se në kuadër të natyrës duhet të fshihen të gjitha konceptet dhe konceptet mbinjerëzore. Të njëjtin projektion Marx-i e ka shprehur për shoqërinë kurse Freud-i për strukturën shpirtërore të njeriut. Të tre këta mendimtarë, me krijimin e teorive më të forta të humanizmit specifik për qytetërimin perëndimor, e kanë plotësuar sistemin e mbyllur të këtij humanizmi, apo thënë më drejtë, e kanë përfunduar ndërtimin e kishës së humanizmit. Në të vërtetë, Darwin-i, Marx-i dhe Freud-i në konceptin shkencor aktual janë mendimtarë të dalë në pension. Teoria e evolucionit, shkencat shoqërore dhe psikiatria kanë realizuar zhvillime të tilla që i lënë shumë mbrapa idetë e Darwin-it, Marx-it dhe Freud-it. Por kompozicioni ideor i të tre mendimtarëve të përmendur jeton si një tërësi besimorë dhe e ushqen humanizmin si një fe. Zaten nuk mund të pritej të ishte ndryshe, sepse njerëzit pasi të abstrahohen njëherë prej dijes, do të ashpërsohen në kuadër të hipotezave pseudo-shkencore, do t'i ngrijnë ato brendapërbrenda "shenjtërisë".

Njëri nga përfaqësuesit e misticizmit evolucionist-humanist të kohës sonë, Teilhard de Chardin thotë se: "Njeriu tashmë nuk është vetëm një qenie që di, por një qenie që di (ose është e vetëdijshme) se është qenie që di". Ja pra, këto fjalë mjaftojnë për të treguar se

ç'fshehet pas shprehjes homo sapiens. Njeriu e ka thyer veten, e ka futur veten në një rreth vicioz.

Nëse dituria tek njeriu ka statusin e diturisë së krijesave tjera, respektivisht nëse njeriu i qëndron besnik diturisë që i është dhënë amanet - sikur që kokrra e drithit e rënë në tokë di të gjelbërojë, blea di të bëjë mjaltë, zogjtë dinë të ulen në folenë e vet për t'i ngrohur vezët nga do të lindin zogjtë, ujëqit dinë të ulurojnë karshi hënës së plotë - atëherë nuk do të ishte e gabuar shprehja "njeriu është një qenie që di". Sepse në këtë rast, në kokën tonë nuk do të lindte ideja se njeriu i derivon dituri vetëvetes. Ne jemi kah vërejmë se vetëm besimtarët, domethënë ata që e kanë konfirmuar sigurinë ekzistenciale në diturinë e dhuruar atyre dhe të cilët njëri-tjetrit ia këshillojnë të vërtetën e durimin, janë ata që bëjnë përpjekje t'i mbeten besnikë diturisë që është karakteristike për njeriun.

Një grup tjetër njerëzish pandehin se mundësia për të kryer diç, për të vepruar ose ditur, buron nga vetë ata. Disa njerëz të goditur nga kjo mënyrë e të menduarit, duke devijuar në konsiderimin e vetes për të vetëmjaftueshëm, siç është 'të qenët i vetëdijshëm se zotëron dituri', e humbin orientimin, lëndësohen dhe bëhen më të padijshëm se një gurë i thjeshtë. Po që se asaj që u përpoqëm ta shqyrtojmë më lartë nuk i shtojmë edhe diç, subjekti në fjalë mbetet i cunguar: Njeriu nuk arrin ndonjë njohuri nëse kupton se "nuk dinë asgjë ata që pranojnë se njeriu është qenie e vetëdijshme se zotëron dituri".

HOMO FABER

Sado që është kritikuar nga brenda dhe jashtë, qytetërimin perëndimor nuk i është shkaktuar plagë që do ta dobësonte aspektin e tij të përbashkët me qytetërimet tjera. Të gjitha qytetërimet e shekujve të kaluar pikërisht si qytetërimi perëndimor janë lindur dhe e kanë ndërtuar sovranitetin e vet nëpërmjet konkretizimit të vlerave të veta origjinale që e kanë mundësuar lindjen e atij qytetërimi dhe nëpërmjet trupëzimit të elementeve që e përbëjnë shpirtin e të njëjtit. Pra, pa marrë parasysh të bëmat e veta, qytetërimet janë bërë qytetërimet vetëm në saje të asaj që kanë ngritur dhe që kanë ndërtuar. Cilësia kolektive e të gjitha qytetërimëve qëndron në pranimin e tyre "bërjen, shpikjen, nxjerrjen në shesh dhe manifestimin" si kusht të ekzistencës. Qytetërimet janë të detyruara të punojnë vazhdimisht që veprat e veta t'ua bëjnë të pranuar të tjerëve, ta ruajnë atë që e kanë themeluar ose ngritur, ta publikojnë atë që e kanë krijuar dhe t'i nxjerrin të drejta ato që i kanë shfaqur. Për këtë arsye njeriu e të gjitha qytetërimëve mund ta quajmë homo faber, domethënë njeri që bën (veprues), punëtor, prodhues.

Ata që e kritikojnë qytetërimin perëndimor, me qëllim të shpëtimit nga rezultatet e dëmshme të tij nuk propozojnë vazhdimin e të bëmave të deritashme, por kryerjen e një pune tjetër, propozojnë veprimtarinë e prodhimit në një fushë tjetër. Në këtë mënyrë, fuqitë perëndimore dita-ditës vijnë duke ndërmarrë masa që qytetërimi të mund ta restaurojë vetveten, hapërojnë në drejtim të riparimit të difekteve të qytetërimin perëndimor. Por në mënyrë absolute mund të pohojmë se të gjitha këto masa nuk mund ta ndryshojnë epilogun e këtij qytetërimi, sepse, çdo fillim është shkuarje kah fundi.

Vështirë mund të parashikojmë se ç'epilog e pret qytetërimin në kuadër të të cilit jemi duke jetuar, sepse ekziston një dallim themelor ndërmjet qytetërimin perëndimor dhe qytetërimëve të kaluara: Qytetërimi perëndimor nuk i ndanë, si qytetërimet e shekujve të tjerë, me një vijë të caktuar elementet që paraqesin bazë të hegjemonisë së vet. Para së gjithash duhet theksuar se nuk ekziston fushë dominimi që do të mund të shprehej me sipërfaqen tokësore të qytetërimin perëndimor. Sikur që bën përpjekje për mbajtjen në dorë tërësisht të globit, po ashtu zotëron edhe projekte për zgjerimin e dominancës madje edhe në përmasa të sistemit diellor. Një veçori tjetër paraqet fakti se qytetërimi perëndimor e ka braktisur politikën e ashpër dhe keqtrajtuese e plaçkitëse të shekullit të kaluar (shek. XIX-A.P.). Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, politika e aplikuar në një formë shumë të kthjellët, bazohet në parimin: njerëzit që duhet plaçkitur së pari duhet prurë në gjendje për t'u plaçkitur. Pra, brengë e vërtetë e bartësve të penjëve të qytetërimin është zhvillimi dhe shpjerja në përparim e elementeve që nuk janë integruar plotësisht në strukturën qytetëruese. E dimë fort mirë se në vendet e varfëra disa qarqe brohorisin në stilin: "Nëse nuk përdorim kompjuterë shkatërrohemi". Por ky avaz është forma inverse e klithmës: "Nëse ata nuk i shtijmë të përdorin kompjuterë shkatërrohemi". Frika më e madhe e qytetërimin perëndimor është ajo që vendet të cilat nuk e kanë plotësuar integrimin modern në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen mos zgjedhin metodë të ndryshme nga metodat e tyre (perëndimorëve), mos gjejnë një rrugë të ndryshme nga rruga në të cilën janë duke ecur ata. Të mosqenët nevojtar i teknologjisë së tyre të hedhur (të dorës së dytë), rënia grusht programeve që e diktojnë hegjemoninë e tyre, do të jetë fundi i qytetërimin aktual i cili bazohet në shitje dhe grabitje. Është për këtë arsye që qytetërimi aktual, që nga lindja dhe përhapja e deri më sot dalëngadalë po pastrohet nga barbarët, të egrit dhe nomadët që mund t'i dalin përpara. Nëse ky qytetërim do ta kishte izoluar veten, nëse do të kishte qenë e mundshme ruajtja e oponencës së

shekujve të kaluar të historisë bota e qytetëruar - bota barbare, ndoshta do të kishte qenë e mundur të themi se barbarët do të ngadhënjëjnë përballë të qytetëruarve. Kjo pikë të cilën e theksoi i pari Ibën Halduni, e ka ruajtur karakterin e vet si dinamikë në marrëdhëniet ndërshoqërore deri në hegjemoninë e qytetërimit perëndimor të makinës. Domethënë, nomadët, si pasojë e ndjenjës së tyre të fortë fisnore ('asabijje) i kanë mundur njerëzit me vendbanim konstant dhe kanë shkaktuar shembje të shumta. Nuk mund t'i mbyllim sytë para të vërtetës se në shembjen e të gjitha konstruktive qytetërimore kanë luajtur rol sulmet barbare, apo më drejt, sulmet destruktive të atyre që në krahasim me njerëzit e qytetëruar kanë mbetur të egër. Natyrisht se nuk është e mundur që këtë qëndrim ta absolutizojmë ose ta shprehim si një ligj sociologjik. Sikur që çdoherë nuk është e mundur që dinamizmin e një shoqërie t'ia etiketojmë egërsisë, nomadizmit të saj, po ashtu ripërkufizimi i qytetërimit dhe egërsisë gjithmonë është në duart tona.

Me të vërtetë, qytetërimi perëndimor ekspansionin e vet e realizoi me një pamje të veçantë. Perëndimorët me një gjenocidizëm dhe gjakpirësi i zhdukën qytetërimet e actekëve dhe inkëve të Kontinentit të Amerikës, të cilin e kishin zbuluar. Por konstrukti shoqëror, zëdhënës të të cilit ishin ata vetë, nuk e përfaqësonte barbarizmin por qytetërimin. Duke i zhdukur lëkurëkuqtë verio-amerikanë shpirtërisht ishin të egër, por nga aspekti i mundësive quheshin të qytetëruar. Procesi i njëjtë u zhvillua edhe në Afrikë, Azinë e largët, Indi dhe Kinë. Ky proces nuk i ngjasonte ballafaqimit i qytetëruar-barbar që u vërejt në shekujt e shkuar. Ç'është e vërteta, mund të dalin edhe të atillë që aventurën ekspansioniste të qytetërimit perëndimor të shek. XIX ia përngjasojnë ngadhënjimit të Romës së qytetëruar përballë Galisë barbare. Nëse një përngjasim të këtillë e shohim të rregullt, në kokën tonë duhet të pikturojmë një Alarik të ri, kurse e tërë vështirësia lind nga mosmundësia për të imagjinuar diç të tillë.

Sot elementet që e kundërshtojnë qytetërimin perëndimor, janë ato që dëshirojnë të marrin një pjesë më të madhe nga turta, ose që duan që turta të jetë më e lezetshme, më ushqyese dhe më pak sëmundjeprurëse. Në skenë ende nuk ka dalë asnjë kundërshtar që të thotë se turta që e ka gatuar ky qytetërim s'meriton të përsoset, por duhet të ngopemi me bukë. Si rezultat i privimit nga ky faktor, qytetërimi perëndimor forcohet dhe zgjerohet edhe më tepër me duart e oponentëve të tij.

Sikur që ekziston dallimi në shembjen e qytetërimit perëndimor dhe qytetërimeve të mëparshme, po ashtu ekziston dallimi edhe nga aspekti i relacionit fitimtar - humbësi ndërmjet qytetërimeve të mëparshme dhe atij aktual. Mund të thuhet se në të kaluarën nomadët me karakter të ashpër dhe modus vivendi të thjeshtë, gradualisht i kanë pëlqyer tiparet e popujve të qytetëruar të cilët i kishin mundur në fushën e luftës, se janë shkrirë brenda institucioneve të tyre dhe janë bërë robër të jetës së përditshme të tyre. Fenomeni i hegjemonisë së qytetërimit perëndimor nuk na shpie në përfundime të njëjta ose të ngjashme me të sipërpërmendurat. Në kohën tonë ngadhënjyesit mundohen që t'i detyrojnë të ngadhënjyerit që me moralin, stilin jetësor dhe mendësinë e tyre t'u ngjasojnë formave dhe modeleve të veta (lexo: formave dhe modeleve të ngadhënjimtarëve-A.P.). Pos kësaj, qytetërimi perëndimor në çdo vend që depërton mundohet që t'i pastrojë (lexo: eliminojë) elementet që e pengojnë vendosjen e tij në atë rreth, t'i mbytë shprehitë dhe botëkuptimet që e përjashtojnë stilin jetësor perëndimor. Mund të themi se njerëzit e qytetëruar hegjemoninë e vet e përforcojnë në saje të aplikimit të vazhdueshëm të barbarizmit.

A MUND TË VIJË DERI TE ZHUKJA E NJERIUT?

Duke e parashtruar pyetjen "vallë, a mund të vijë deri te zhdukja e njeriut?", nuk kam për qëllim të përkujtoj zhdukjen tonë në Ditën e Fundit. Përkundër kësaj, pyes nëse do të zhduket njeriu si pasojë e të vërtetës se njerëzit jetojnë duke formuar dita-ditës turma të mëdha, duke i futur hundët në gjithçka, duke e shfaqur qenësinë e vet në çdo hap të rruzullit tokësor.

Në themelin e një çështjeje të këtillë qëndron e vërteta se qytetërimi i teknologjisë, individit njerëzor nuk i jep funksion tjetër pos të qenët pjesë e makinës. Në qytetërimin në kornizat e të cilit jemi duke jetuar, qenia e quajtur njeri është "materializuar, është bërë send". Pozita që zë në rruzullin tokësor, forma organizative e shoqërisë, aparatet që i ka prodhuar me dorën e vet, ndërtesat dhe lehtësimet jetësore, kanë shkaktuar që kjo qenie të perceptohet si një gjë e zakonshme, si një send me të cilat ai hyn në marrëdhënie ose kontakton. Sikur njeriu nuk është krijesa më e ndershme, por një pjesë e thjeshtë e botës. Në qytetet që vetë i kemi ngritur, njeriu është shtyrë në pozitë të elementit shtojcë (margjinal-A.P.). Në kuadër të sistemeve të mëdha të ujitjes, linjave të energjisë elektrike, rrugëve, liqeneve artificiale me madhësi të tillë që ato natyroret t'i tregojnë si të pavlefshme, në tokat e mbjella që kaplojnë miliona kilometra katrorë, në komplekset e mëdha industriale, njerëzit nuk janë udhëheqës, drejtues, por në identitet të elementeve që sigurojnë funksionimin e këtyre resorëve, në identitet të pjesës përplotësuese.

Le të mendojmë në këtë trajtë: Sikur që në një kopsht zoologjik kafshët as tek e tek e as si tërësi nuk mund ta ruajnë vlerën e vet dhe "kopshti zoologjik" ka një domethënie mbi të gjitha kafshët edhe në kuadër të qytetërimit, njeriu në suaza të institucioneve lëndore dhe shpirtërore të krijuara nga vetë ai, në suaza të veglave dhe vendeve është zvogëluar (minimizuar), është atrofuar dhe i ka lëshuar penjtë nga dora. Sa do të vazhdojë ky proces? A thua do të mbërrihet një ditë kur nuk do t'i biem në të ose nuk do ta ndiejmë as zhdukjen e njeriut? Nuk e dimë...! Ajo që mund ta dimë dhe që duhet ta dimë është e vërteta se si mund të arrihet që njeriu ta fusë në dorë njerëzi(shmëri)në e vet, si mund të vijë në situatë kur roli i tij në skenë do të jetë më i çmuar.

Duke filluar të mendojmë në këtë subjekt, së pari duhet të përkujtojmë se konceptet "njeriu" dhe "njerëzimi" edhe pse janë elemente plotësuese dhe të domosdoshme për njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë janë edhe elemente oponente dhe që kur i vjen radha, e zhdukin njëri-tjetrin. Njeriu si individ nëse nuk lindet dhe rritet në një shoqëri njerëzore, nuk mund t'i arrijë cilësitë e të qenët njeri. Të qenët njeri është gjë e patjetërsueshme për të qenë pjesë e tërësisë së quajtur njerëzimi. Por përkundër kësaj, nëse individi formësimin, prioritetin e vet nuk e siguron me anë të disa kualiteteve të veta specifike (sui generis - A.P.), nuk mund të bëhet njeri në plotkuptimin e fjalës. Njeriu mund të konsiderohet njeri në plotkuptimin e fjalës nëse e shijon sekretin e ekzistencës së vet. Ata që nuk e shijojnë këtë sekret, si një tullë e ndërtesës së ngritur nga soji i Ademit, bëhen send dhe "gjësohen". Ja pra qytetërimi i teknologjisë, meqë e ka bërë dominant një sistem i cili mundësitë dhe gjasat e njeriut për të qenë primar e prioritar i zbret në minimum, realitetin e njeriut e nxjerr në skenë si një armik të realitetit njeri.

Në këtë gjendje nga aspekti i ndierjes dhe shpalljes së prioritetit të vet, për çdo individ lind domosdoshmëria e kërkimit të një metode ose rruge. Parapëlqimi i disa sjelljeve me karakter të show-it nga ana e njerëzve modernë, si pasojë e ndjekjes së disa rrugëve ekstreme, përfshirë këtu edhe vetëvrasjen, arritja në ekstremizëm në çështjen e seksit, prirjet e tyre për terror, idhullizimin e vetes dhe tjetrit, janë rezultat i privimit nga të

ndjerit e prioritetit në botët e tyre të brendshme dhe i braktisjes së tyre vetveten në duart e një detyrimi të jashtëm ose në duart e një sere detyrimesh.

Njeriu, kur ndjen se do të zhduket dhe se në aktualitet në masë të madhe është zhdukur, qoftë duke e copëtuar personalitetin e vet qoftë duke i shembur të ngjashmit me të në pamje të njeriut, i drejtohet dhunës. Në kushtet e sotme jo vetëm dhuna, por gjithashtu edhe nënshtrimi ndaj sistemeve në fuqi, organizatave që e zhdukin njeriun, paraqesin një lloj të rrugës së kërkimit të vetvetes. Njeriu e nxjerr mallin e ndierjes së vetvetes edhe duke konsumuar për së tepërmi (hiperkonsumimi), duke i pranuar si të vërteta të pakontestueshme të dhënat që ia servojnë mediumet, duke treguar vartësi dhe lidhshmëri të tepërt ndaj pijangove (bingove), ndaj rrugëve të kënaqësive dhe zbavitjes që i lejon sistemi, nënshtrimit kushteve të punës etj. Brenda këtij karvani gjejnë vend edhe ata që vrapojnë pas rekordeve të çuditshme, ata që përpiqen të bëhen heronj të punës (mundit), ata që përgatisin skandale për vetveten.

Në një ambient jetësor ku çdo gjë lidhet me pamjen 'e jashtme', çdo përpjekje për ta mbrojtur vlerën e njeriut nuk luan rol tjetër pos përshpejtimit të procesit të zhdukjes së njeriut, sepse vlera e njeriut qëndron në marrëveshjen që ai e ka bërë me Zotin. Nëse njeriu e prish miqësinë me njohurinë dhe diturinë që ka arritur deri te ai përmes revelacionit (vahj), përpjekja e tij për mbrojtjen e vlerës së vet me duart e njerëzve do të thotë mosdije se ku qëndron dhe sa është vlera e njeriut. Kjo mosdije e ka kuptimin e të mbeturit pa zgjidhje dhe i pafuqishëm karshi zhdukjes së njeriut.

SIGURIA ONTOLOGJIKE

Koncepti ontologji ka kuptimin e shkencës mbi qenien ose ekzistencën. Ontologjia si një pjesë përbërëse e metafizikës, është disiplinë shkencore e orientuar kah të konceptuarit e thelbit të gjësë së quajtur "qenie". Ontologjia është përpjekje për ta kuptuar qenien duke e abstrahuar nga të gjitha elementet që e përcaktojnë atë.

Çdo njeri, me qëllim ose pa të është në relacion të ngurtë me thelbin e qenies së vet. Kuptohet se, ky relacion e manifeston shkallën e vetëdijes së personit përkatës lidhur me jetën, bile mund të thuhet se në saje të relacionit të njeriut me ekzistencën mund të kuptojmë nëse x personi është i vetëdijshëm ose jo. Çdo njeri që konsiderohet se është me mend në kokë, nga pikëpamja e diturisë së ekzistencës pranohet se gjendet nën flatrat e sigurisë. Luajtja mendsh e njeriut do të thotë zhbërje e fushës së sigurisë ontologjike të tij. Në jetën shoqërore siguria përfitohet me adaptimin ndaj normave shoqërore, modeleve dominante të sjelljes në shoqëri, me adaptimin ndaj mënyrave të perceptimit të botës (që dominojnë në atë hapësirë). Te njeriu nuk ekziston ndjenjë më e fortë, më e nevojshme se sa të ndjerit e vetes në siguri përballë ekzistencës, pa marrë parasysh rrugët përmes të cilave arrihet e njëjta. Po ashtu edhe të gjitha rrugët e satisfaksionimit që emërohen si nevoja, nga këndvështrimi i njeriut drejtpërsëdrejti janë të lidhura me sigurinë. P.sh., uria mund të na duket si një nevojë e thjeshtë në suaza të funksionimit të organizmit. Kurse e vërteta është se edhe në themelin e urisë qëndron kushti i sigurisë të cilën organizmi e ndjenë lidhur me ekzistencën e vet, brenga për mbrojtjen e vetvetes. Prirja për evitimin e urisë është një vazhdimësi e brengës që mund ta marrë nën mbrojtje qenien e vet. Uria është e rëndësishme po aq sa një rrezik që i kanoset ekzistencës; faktori që e rrezikon ekzistencën më tepër se sa uria përnjëherë kalon në rendin e parë.

Njeriu me pjesëmarrjen e tij në jetën shoqërore e plotëson me elemente të ndryshme fushën e sigurisë së vet ontologjike. Rënia e njeriut në pasiguri është pasojë e humbjes së prestigjit, shprehive, dashurive e shpresave. Për këtë arsye çmenduria mund të lidhet me faktorë të shumtë. Individu, si pasojë e lidhjes së tij nga shoqëria e qytetëruar me zinxhira të marrëdhënieve komplekse dhe artificiale, është sjellë në gjendje të mundësisë për t'u plagosur nga shumë anë. Sa më tepër që të ndërlikohet jeta, aq më tepër lindin elemente të cilave mund t'u besohet dhe të cilat shkaktajnë pasiguri.

Nëse edukata, botëkuptimi, mjetet e satisfaksionit të njeriut të caktuar përputhen me gjykimet, modus vivendin e shoqërisë në cilën është duke jetuar, kjo do të thotë se ky individ e ka mundësinë që shumë lehtë ta arrijë sigurinë e vet ontologjike. Nga ana tjetër, individit që nuk i pranon vlerat në fuqi të shoqërisë dhe që për arsye të ndryshme bie ndesh me këto vlera, i kanoset rreziku i pasigurisë ekzistenciale. Domethënë se çdo individ që hyn në konflikt me strukturën shoqërore, me nivelin logjik të shoqërisë dhe trajtën dominante të të konceptuarit të gjërave, e ka në rrezik shëndetin shpirtëror.

Veçoritë që gjenden në thelbin e njeriut dëshirojnë të gjejnë kundërvlerën e vet në shoqëri. Këto veçori janë të karakterit bipolar, si p.sh.: miqësia/armiqësia, harrimi/besa, besnikëria/tradhtia. Sjelljet njerëzore të shprehura përmes fjalëve miqësia, besa, respekti, mbajtja e fjalës, qëndrimi besnik amanetit, ruajtja e fshehtësisë etj., në mënyrë të drejtëpërdrejtë janë të lidhura me arrijtjen e sigurisë ekzistenciale të njeriut. Qytetërimi, duke e reduktuar miqësinë në ortakëri të profitit, besën në prestigj afarist, respektin në adhurimin e epërsive aparente, është orientuar kah shembja e hapësirës së sigurisë ekzistenciale të njeriut. Këto ndryshime në sferën e normave morale-etike, që kanë lindur në kuadër të qytetërimit, e kanë ndërlikuar stilin jetësor të njeriut. Në kuadër të jetës së

qytetëruar, jeta e njeriut është e mundshme vetëm duke kaluar nëpër konsekuenca shumëkatëshe. Në një qytet të madh, madje edhe vetëm për të ecur, duhet të zotërosh të dhëna të panumërta të qytetërimit. Të gjitha këto detyrime, çdo njeri që "e lodhë kokën" e çojnë të mendojë nëse ekzistenca ose qenia e tij është autentike ose jo. Pas nënshtrimit ndaj të gjitha këtyre rregullave, ndaj gjithë kësaj "gjithësie" që ka lindur nga njerëz të ngjashëm si ne, parashtrohet kjo pyetje: "A jemi në gjendje që ende të mbetemi njerëz?" Nëse jeta e jetuar në kornizat e strukturës së qytetërimit me të vërtetë është jetë, lind pyetja pse njeriu i qytetëruar e ndjen nevojën që t'i disiplinojë dhe t'i mërzhisë njerëzit duke i detyruar që vazhdimisht të tregojnë sjellje të cilave ata nuk u besojnë, nuk i simpatizojnë dhe të cilat nuk i pranojnë si të drejta? Domethënë se ekziston një disharmoni ndërmjet specifikave të thelbit të vet dhe kushteve të jetës. Në këtë situatë njeriu ose do t'ua adaptojë ato vlerat e veta morale dhe intelektuale kritereve shoqërore në fuqi, ose do të kërkojë një ambient ku do të mund t'i jetojë ato (vlerat e veta). Nëse nuk ia arrin njërës prej dy alternativave, do të vijë deri te tronditja e ndoshta edhe deri te copëtimi i sigurisë së tij ontologjike.

Këtë njeri ne do ta quajmë të marrë ose të çmendur, sepse emërtimi i atij njeriu si "i marrë" do ta fsheh hipokrizinë tonë. Ne jemi "të mençur" sepse jetojmë duke u sjellur gjoja se i kemi pëlqyer të gjitha vlerat dhe gjykimet dominante në shoqëri.

VELIJJULLAHU

Fusha e sigurisë ontologjike, në vartësi me nivelin kuptimor të çdo njeriu është e ngushtë ose e gjerë. Shumica dërrmuese e njerëzve gjenden brenda sigurisë ekzistenciale aq sa u mundësojnë kushtet materiale dhe ato të solidaritetit shoqëror. Domethënë shqetësimet e tyre në sferën e ekzistencës janë të kufizuara me të ardhurat (fitimin) dhe mjetet e satisfaksionit që janë kundërvlerë e të ardhurave. Kjo gjendje e shpjegon faktin e humbjes shumë lehtë të sigurisë lehtë të përfutur. Ata që sigurinë ekzistenciale e arrijnë në një hapësirë të ngushtë, këtë siguri e humbin menjëherë posa të dalin jashtë asaj hapësire të ngushtë.

Kjo është arsyeja pse njerëzit e sëmurë mentalisht më tepër rastisen nëpër shtresat e pasura shoqërore sesa në ato tjerat. Njerëzit më të pasur, e kanë më rëndë të mbrohen kundër grushtave, jo për arsye se mendojnë më hollë, por për arsye se kushtet jetësore i gjejnë "të gatshme", sepse mbesin të papërgatitur përballë kushteve që ndryshojnë. Pikërisht për këtë mund të themi se disa privime ose mungesa e zgjerojnë fushën e sigurisë ekzistenciale, sepse çdo vështirësi inicon zbritjen në thellësitë e marrëdhënieve njerëzore, tregon se siguria e marrë në mbrojtje nga Qenia është shumë përtej të dukshmes (fizikes, imanentes - A.P.). Personi që e zgjeron hapësirën e konceptimit, e di fort mirë se siguria e tij nuk mund të vijë nga gjëja që e para na del para syve. Ç'është ajo e cila e para na del para syve? Janë shëndeti dhe rehatia e organizmit, zënia e individit një pozitë të çmuar në shoqëri.

Ata që mendojnë se mbajtja e sigurisë nuk arrihet me shëndetin dhe rehatinë e organizmit e as me lidhjen pas vlerave shoqërore në fuqi, kërkojnë rrugë për ta siguruar qeniediturinë. Individit i cili një herë e kupton se faktorët që e bëjnë atë njeri nuk janë as cilësitë trupore e as vlerat që atij i përshkruhen nga rrethi, duke i besuar pamjaftueshmërisë së shtyllës që atij ia ofrojnë natyra dhe shoqëria në sferë të sigurisë, hyn në një "rrugë", në fundin e secilës gjendet siguria absolute e pritur.

Kësaj rruge nuk mund të shkohet pa e vërejtur mashtrueshmërinë e elementeve në natyrë dhe shoqëri që duken sikur japin siguri. Kësaj rruge nuk mund të shkohet për hir të një mundësie që do të aprovohet në shoqëri dhe që do t'i përmirësojë kushtet e sigurisë në natyrë. Kur nga populli ose krijesat largohet mundësia e sigurisë atëherë njeriut i hapen rrugët. "Rruga" del në skenë nëse njeriu sigurinë ekzistenciale e kërkon në fushën e specificitetit të të qenët njeri. Domethënë rruga nuk është një strehimore e paevitueshme që është rezultat i vështirësive me të cilat njeriu ballafaqohet në ambientin jetësor. Detyrimi i kushteve lëndore të ambientit, njeriut, më tepër ia siguron të kapurit për gjërat e skajeve të rrugës se sa që e drejton atë rrugës.

Ai që ia arrin suksesit të mësojë që lëndoren mos ta shohë si domosdoshmëri, mund ta bëjë hapin e parë në rrugë.

Miqësia e njeriut me Zotin fillon në pikën e mosgjetjes në asnjë mënyrë të kushteve të sigurisë ekzistenciale në kuadër të kushteve të ambientit lëndor të quajtur mâ sivâ.* Njeriu i hyrë në rrugë është ai që fushën e sigurisë ekzistenciale e ka zbrazur nga sendet ose objektet e krijuara. Ata që ecin rrugës, në çdo stacion e gjejnë sigurinë karakteristike të vendit përkatës. Çdo vendbanim është vend i sigurisë. Por rruga është e gjatë ndërsa stacionet të shumta.

Velijjullahu nuk është vetëm person që veten në kuptimin absolut të fjalës e ka vendosur në fushën e sigurisë ekzistenciale (duke i besuar dhe duke iu mbështetur Zotit), por në të njëjtën kohë ka arritur eficiencën kur mund edhe tjetrit që ec rrugës t'ia tregojë fushën e

kësaj sigurie. Sepse, ai ka udhëtuar dhe sa ka udhëtuar aq është kthyer prapë. Ai në konstruktin e vet zotëron aftësinë për t'u treguar atyre që janë duke udhëtuar recetën se si mund të mbrohen nga rreziqet. Rreziqet që i presin ata që i bëjnë hapat e parë të udhëtimit siç mund të jenë sulmet e botës së jashtme, po ashtu mund të jenë edhe problemet dhe gabimet e botës së brendshme.

Velijjullahu është i pajisur me pasuri të brendshme deri në atë masë saqë nuk bëhet bashkëbisedues i sulmeve që vijnë nga bota e jashtme. Gjithçka që grufullon nga bota e jashtme nuk ka të bëjë me dallgëzimet emocionale. Në kuadër të një shëndeti të këtillë, velijjullahu merr përgjegjësi në botën e fenomeneve. Velijjullahu, i cili fushën e sigurisë në tërësi ia ka dorëzuar All-llahut (xh.sh.), mund t'u "injektojë" stabilitet edhe atyre që ende bartin shqetësime lidhur me mâ sivâ-në.

Kuptohet se te të gjithë njerëzit ekzistojnë brenga dhe frika në lidhje me sigurinë ontologjike. Dikush mundohet që këtë tension ta baraspeshojë duke i rregulluar kushtet ambientale dhe ndodh që disa herë të arrijë sukses. Por siguria që e arrin duke i rregulluar kushtet ambientale është një siguri e arritur nga shurdhëria dhe verbëria.

Mirëpo disa nuk mund t'i mbyllin sytë e veshët. Kështu, atyre u hapet mundësia për zgjerimin e fushës së sigurisë. Atij që nuk kërkon ndihmë askush nuk i ndihmon. Atij që thotë "e gjeta sigurinë" nuk i hapet rruga e gjetjes së sigurisë së vërtetë. Atij të cilit velijjullahu ia tregon fushën e sigurisë, i ngarkohet përgjegjësia e pasojave që do të lindin nga ky akt.

MUZGU

Udha të cilën njerëzimi e ka zgjedhur për të shpëtuar në të njëjtën kohë e ka edhe kuptimin e zgjedhjes së udhës së shkatërrimit. Domethënë njeriu duhet ta dijë se shkatërrimi i vjen nga dora të cilës ia ka besuar shpëtimin. Fuqia që nuk mund të shkatërrojë, nuk mund të shpëtojë dikë; nuk ekziston e mirë që nuk ta përkujton të keqen dhe e keqe që nuk e fton të mirën.

Nëse ankohe mi nga pislleqet dhe rreziqet e një jete të varur nga konsumimi i energjisë, le ta përkujtojmë mosdisponimin (shqetësimin që e ndiejmë) nga fakti pse jetën tonë nuk e kemi bërë energjike. Nëse e mbrojmë mendimin se shkenca ka rënë në pozitë kur i bën shërbëtori (lexo: robëri) teknologjisë, se filozofia dhe mendimi përgatisin arsyetimin e çdo despotizmi, se arti i përgatit hapësirë jete sharllatanizmit, le të përkujtojmë rëndësinë që ia kushtojmë identitetit të shkencës, filozofisë dhe artit të orientuar kah levërdia "shoqërore". Duhet të kemi parasysh se afinitetet e njerëzve për ta gjetur të drejtën në vartësi të zgjedhjeve të veta dhe mudi i tyre i dhënë në këtë drejtim, janë burim sa i lumturisë aq edhe i shkatërrimit të tyre.

Biri i Ademit si dje ashtu edhe sot, atë që e bën për të shpëtuar e bën edhe për t'u shkatërruar. Shkollat tona njerëzve ua zgjerojnë horizontin e njohurive, por në ndërkohë i përforcojnë edhe themelet e mosditurisë. Spitalet tona me njërin dorë i shtojnë diç shëndetit tonë e me dorën tjetër i cungojnë diç. Rrjeti i rrugëve dhe mjetet e komunikimit masiv sado që e lehtësojnë jetën tonë, sado që e përshpejtojnë qarkullimin e informacioneve, po në të njëjtën masë e zvogëlojnë ngrohtësinë që njerëzit e ndiejnë nga afërsia ndaj njëri-tjetrit, e pakësojnë thellësimin e ndikimit të komunikimit ndërnjerëzor. Organizatat tona shoqërore sado që i shërbejnë rrjedhës së rregullt të jetës sonë, e sjellin sigurinë e të jetuarit në vartësi të normave, në të njëjtën kohë janë edhe burim i frikës që ndjehet nga një mekanizëm i fortë i trysnisë.

Jeta jonë rrjedh nën hijen e një muzgu. Ndoth që edhe jeta e pararendësve tanë të ketë rrjedhur gjithnjë në muzg. Pozita jonë si njerëz është kjo: Në errësirë sa të mund ta dallojmë dritën dhe në dritë sa të mund ta njohim terrin. Ata që do të na e sjellin dritën e nevojshme për jetën tonë janë njerëzit që i kanë rënë në të errësirës që e mbërthen jetën tonë. Për këtë arsye është e kotë të presim që njerëzimit t'i sjellin dritë ata që nuk e dinë se cilët janë faktorët që e errësojnë jetën e njeriut.

Atëherë pra ç'është errësira? Ç'është drita?

Sipas disave bota është errësirë për shkak të të këqijave siç janë uria, eksploatimi, varfëria dhe padrejtësia. Nëse "kapemi" pas këtij mendimi, botën ku njerëzit janë të ngopur, ku nuk e eksploatojnë njëri-tjetrin, ku jetojnë në prosperitet dhe nuk i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit duhet llogaritur për botë të ndritur. Aspekti çalues i këtij mendimi është ky: Nëse synojmë ta evitojmë plotësisht gjënë që e dimë për të keqe dhe t'ia arrijmë qëllimit, si do ta kuptojmë se ç'kemi bërë, ç'kemi evituar ose asgjësuar. Në një atmosferë kur të gjithë njerëzit jetojnë në bollëk, a është e mundur ta kuptojmë të vërtetën nëse të njëjtit jetojnë ose jo në bollëk? Në një mjedis ku të gjithë njerëzve u qeshet fytyra, si do ta kuptojmë se ata që janë të buzëqeshur janë njerëz të mirë?

Nuk duhet përsëritur se ç'dobi kemi në drejtim të konstatimit të së vërtetës nga antagonizmat që i hasim në jetën tonë. Të bukurën mund ta kuptojmë në saje të së shëmtuarës, të mirën në saje të së keqes, të vërtetën në saje të gënjeshtres ose të pavërtetës. Pika në të cilën duhet ndalur këtu është: cili do të jetë kriteri i vlerësimit të antagonizmave? Varfëria dhe pasuria në vetvete nuk janë gjëra të mira ose të këqija. Sikur

që të qenët i gjatë ose i shkurtër, të qenët para ose mbrapa, në vetvete nuk mund të konsiderohen si gjëra pozitive apo negative.

Ajo që ne si njerëz mund dhe duhet ta bëjmë nuk është të përpiqemi t'i abrogojmë antagonizmat, por ta dimë pozitën tonë që zëmë në njërin nga polet gjegjëse. Atëherë ne mund të dallojmë se ç'domethënie kanë për ne drita dhe errësira në çdo gjendje dhe në çdo kusht e rrethanë. Atëherë kuptojmë se në këtë botë të antagonizmave duhet të bartim përgjegjësinë e të qenët njeri.

Njeriu në këtë shekull kurthin më të tmerrshëm vetes ia ka përgatitur duke e marrë shpëtimin e vet nga fusha e realitetit dhe duke ia lidhur një skeme të re shoqërore. Shekulli XX na ka treguar se njeriu i cili shpëtimin e kërkoi në botën e iluzioneve, është shkatërruar nga iluzionet e veta.

Gjendemi në muzg. Muzgu nuk e ka vetëm kuptimin e kohës para agimit por në të njëjtën kohë e shpjegon edhe gjendjen kur dielli posa është humbur në horizont. Nëse themi se jemi në muzg, themi se gjendemi pas diellit të perënduar dhe para ditës që do të agojë. Jemi të mbërthyer me shumë gjëra, për këtë arsye shumë gjëra mund t'i lëmë jashtë vetes. Një gjë të tillë e kërkon e vërteta se jemi njerëz. Nuk jemi të ngarkuar vetëm me mendje sikur engjëjt e as vetëm me epsh sikur kafshët. Ekzistenca jonë është formuar nga takimi i antagonizmave.

AJO QË DUHET KËRKUAR

"Sikur ta kishim ditur arsyen e udhëtimit prej djepit deri në varr - thotë Maurice Maeterlinck - gjatë tërë rrugës do të ecnim duke kënduar mu si fëmijët që janë lëshuar nga shkolla".

Specifika që ne, si muslimanë, kohë pas kohe na bën të shqetësohemi, na bën të djersitemi dhe të nevríkosemi e të bëhemi polemistë është telashja 'të tregojmë se jemi në të drejtë, se besimi ynë është besim i vërtetë dhe sa me vlerë është thirrja jonë drejtuar të tjerëve që edhe ata t'i bashkangjiten rreshtit tonë'. Duket qartë se kjo telashe është një tregues se jemi orientuar ta shtyjmë veten t'u besojmë disa të vërtetave. Orvatemi të mos i lëshojmë duarsh kushtet e të menduarit në siguri. Sikur të mos ishte kështu, domethënë nëse të qenët tonë në të drejtë do të ishte për ne një gjë e evidente, nëse autenticiteti i besimit tonë do të përputhej me gjendjen tonë, në veprat tona nuk do të kishim nevojë të tregojmë kurrfarë ekspozimi. Kundër armiqve tanë nuk do të nevríkoseshim dhe dialektikën do ta largonim nga trajtat e sjelljeve tona. Njeriu, kur mundohet t'ia tregojë tjetrit vlerën e taborrit ku bën pjesë, ndërkohë vërtetësinë e vet dëshiron ta jetojë me një shembull konkret të ri.

Duhet shtuar se sjelljet që i cekëm nuk janë qëndrime që duhet dënuar aq shumë, sepse ne qysh me të ardhur në këtë botë biem në një enigmë. Me të qenët muslimanë fusim në dorë një kapëse lidhur me metodën, në saje të së cilës dalëngadalë do ta zgjidhim këtë enigmë. Për këtë arsye shqetësimin, emocionimin, ngatërimin tonë nuk duhet shikuar me habi ose si gjëra të shëmtuara.

Enigma më e madhe e njeriut është të qenët i krijuar. Pasi i biem në të kësaj enigme fillojnë çështjet në marrëdhëniet thelbësore ndërmjet Krijuesit dhe njeriut, çështje këto që çdonjëra veç e veç mjafton për ta përfshirë jetën e një njeriu.

Të diturit pse shkojmë nga djepi në varr, do të thotë zbulim i domethënies sonë në një "han dydyersh". Zbulimi i këtij kuptimi - pa marrë parasysh shkallën në të cilën e kemi arritur - na mjafton për të qenë nën hijen e sigurisë. Është ndjenja që vjen nga konsiderimi i vetvetës të burgosur brenda enigmës të "të qenët i krijuar" ajo e cila neve muslimanëve para jomuslimanëve na tregon si agresivë, të ashpër dhe të mbyllur. S'do mend se ajo që duhet kërkuar janë mënyrat e zgjidhjes së kësaj enigme. Madje edhe njohja e vetes si i burgosur brenda kësaj ndjenje, ka kuptimin e hapërimit në drejtim të rrugës së zgjidhjes. Përderisa vetë qëndrojmë i mbyllur në korniza të enigmës së "të qenët i krijuar", si mund t'i hidhërohëm paditurisë së tjetrit për ekzistencën e kësaj enigme?

Të qenët musliman, gjegjësisht nënshtrimi të së Vërtetës (el-Hakk) së pari më mëson se enigma është e zgjidhshme, e mandej, se zgjidhja e saj mund të realizohet përmes udhës që kalon nëpër Kur'an dhe Sunnet. Në këtë pikë, nëse nuk kam kurrfarë dyshimi, nëse nuk jam i mbërthyer nga dëshira për të gjetur ndonjë mjet dhe vegël ndihmëse, nëse besoj se rruga do të më shpie në zonën e sigurisë dhe besimit pa pësuar aspak, atëherë shpëtoj nga tensionimi i qenies sime përballë të tjerëve, nga dallgëzimet mendore në mesin e jomuslimanëve, nga telashja për t'u treguar të tjerëve se kam shumë të drejtë në veprat e mia. Sepse fitoj siguri lidhur me pyetjen "pse shkoj" dhe kjo siguri sa mua po aq edhe të tjerët ka filluar t'i bëjë të sigurt. Kuptoj se mossiguria ime do ta shpie në pasiguri çdokënd që hyn në rrethin tim. Nëse ndodh e kundërta, unë duke e ndjerë veten në siguri, edhe të tjerët do t'ia arrijnë mundësisë për ta njohur dhe ndjerë fushën e quajtur "fushë e sigurisë". Ajo që duhet kërkuar nuk janë mënyrat se si ta bindim tjetrin por bindja e vetvetes. Muslimani nëse e di pse shkon nga djepi në varr, nuk ka nevojë që këtë dituri ta stolisë

dhe ta bëjë sa më tërheqëse për tjetërkënd, sepse sjellja e tij e rehatshme dhe e sigurt në këtë subjekt, vetvetiu do të bëhet një atraksion. Atëherë mund të mendojmë se do të përjetojmë një çlirim nga robëria dhe kjo gjendje e lirisë do t'i tërheqë të tjerët. Domethënë siguria që ia kemi gjetur vetes në rrugën që shkon nga djepi në varr, është burimi i sigurisë të cilën mund t'ua ofrojmë të tjerëve. Metodatat e shekullit tonë si propaganda, larja e trurit dhe kushtëzimi, janë rrugë përmes të cilave individit u bën trysni të tjerëve t'u besojnë gjërave të cilave ai vetë nuk u beson. Të kërkuarit e muslimanëve një "metodë të bindjes së tjetrit", do të thotë se ata sistemin e vet të besimit e shohin në shkallë të një doktrine të rëndomtë, e kjo gjë ka gjasa të jetë argument se ata e kanë braktisur diturinë sui generis të Islamit.

ATRAKSIONI

Atraksionet janë faktorë që në masë të madhe na udhëheqin. Personaliteti ynë del në shesh me gjërat që i shohim si atraktive. Gjërat atraktive pas të cilave "e japim ose e humbim veten" mund të na çojnë ku të duan. Sa në të mirë aq edhe në të keqe. Parashtrohet pyetja se a thua atraksioni i ka tiparet e veta që e kaplojnë çdo njeri, që e ruajnë vlerën e vet në çdo kulturë dhe kohë? Mendoj se jo. Gjërat që i mahnisin njerëzit ndryshojnë nga njeriu në njeri. Çdo mjedis kulturor ka derivuar gjëra që e mahnisin atë. Por, jemi të detyruar të themi se muslimanët përgëzues dhe shpjegues "mbajnë në dorë" atraksionin që vlen për çdo njeri dhe që gjen refleksionin e vet në çdo rreth kulturor. Muslimani komunikues në të njëjtën kohë është njeri që di ta tërheqë drejt vetes dikë tjetër. Edhe artistët e çojnë përpara punën e vet duke qenë të bindur se janë kanal absolut (e jo relativ) i atraksionit. Te artistët e lartë dhe cilësorë, ekziston një atraksion që e tërheq çdokënd, që në çdo kulturë dhe kohë "shpreh diçka".

Thamë se ne, një atraksioni të caktuar i dorëzohemi në pajtim me karakterin dhe në suazat e personalitetit tonë. Por a nuk ekzistojnë gjëra të cilat çdo njeri i konsideron tërheqëse? Kohë pas kohe çdokush në të njëjtin çast a nuk mahnitet nga gjëja e njëjtë? Në këtë rast, a do të flasim për pikën e përbashkët të karakterit të kolektivitetit njerëzor, apo do të pretendojmë se dallimet e personalitetit zhduken para disa atraksioneve të fuqishme? Asnjëra nuk është e vërtetë. Në të vërtetë, gjëja ose ngjarja që e mahnitë çdokënd, në çdo personalitet shkakton reagime të ndryshme. Sipas kësaj, edhe pse në dukje të parë shohim se është e njëjta gjë që i ka mahnitur të gjithë, në të vërtetë vërejmë se nga perspektiva e atyre që e kanë perceptuar atë kanë lindur atraksione të ndryshme. Ky fenomen e shfaq veten me të gjitha dimensionet e veta në raportin ndërmjet njeriut dhe natyrës. Njeriu shijon nga pjesa e natyrës të cilën e konsideron tërheqëse ose mahnitëse në raport me nivelin e të kuptuarit dhe shpirtit të tij. Gjëja që e mahnit atë veçmë nuk është fenomeni natyror ose gjendja momentale e natyrës, por kuptimi të cilin ai ia jep asaj (natyrës). Për këtë arsye është marrë guximi të thuhet se natyra e imiton artin.

Marrëdhëniet relative ndërmjet natyrës dhe njeriut vlejné edhe për fenomenet shoqërore. Çdo shekull dhe çdo rreth shoqëror "prodhon" fokuset e veta specifike të atraksionit, i cili në çdo shekull ose rreth shoqëror e (për) plotëson kuptimin e vet. Në kohën tonë po "prodhohen" atraksione, tërheqshmëri të detyrueshme, njerëzit mashtrohen me atraksione artificiale dhe rrejshme. Në fillim të periudhës së prodhimit të makinerike, vetë malli (produkti) ka qenë tërheqës për njerëzit, kurse sot zotërues i atraksionit është fjala, maksima (logoja) e një produkti. Fenomeni i quajtur reklamë është orientuar që njeriun ta përmasallojë për një gjë inekzistente, është orientuar kah gjenerimi te njeriu një nevojë nga hiçi e cila vazhdimisht do ta mendojë e do ta brejë atë. Jeta artificiale e shënuar në periudhën para Revolucionit Industrial te aristokracia dhe qarku i pallatit, sot i ka infektuar të gjithë njerëzit. Kjo është një botë që prodhon atraksione për njerëzit. Ne jemi të detyruar të "luftojmë" ta shembim këtë botë të atraksioneve që vazhdimisht na e pret udhën dhe të jetojmë në një rreth të atraksioneve ku dominojnë vlerat islame. Kur mundohemi të bëhemi tërheqës duke u veshur bukur, duke e rritur tërheqshmërinë e mallrave konsumuese, në skenë nxjerrim kritere të dyshimta vlerash. Të jeshë tërheqës në bazë të stilit të konsumuarit në të njëjtën kohë është shenjë e mahnitjes me mjetet konsumuese. Kur sharmet tona i kufizojmë me teket, botëkuptimet dhe mënyrën e narracionit tonë, ndërkohë tregojmë se gjërat që na fascinojnë janë të njëjtat vlera.

Kërkimi dhe gjetja e sharmit që buron nga thelbi ynë dhe specifikimi i sharmit tonë vetëm për thelbin tonë, paraqet pikën kulmore të asaj që mund ta bëjmë në këtë lëmi.

Gjërat që ne i konsiderojmë atraktive, pjesët tona që mundohemi t'i bëjmë tërheqëse, si përfundim do të jenë edhe një shenjë e mënyrës se si ne e kuptojmë Islamin. Ndjenja jonë e estetikës, qëndrimi që e kemi pëlqyer si stil i të menduarit, modus vivendi (mënyra e jetesës) ynë, pak a shumë janë simptom i vendit ku gjendemi në sferën e besimit.

Të gjitha veprat tona i bëjmë nën shtypjen e shijeve. Pse jo kjo ngjyrë por tjetra? Pse jo kjo poezi por ajo? Pse hamë në këtë formë e jo në atë? Të gjitha këto janë të lidhura me botëkuptimet tona, e botëkuptimet tona drejtpërsëdrejti janë të lidhura me besimin.

MASHTROHEMI...

Veten e kemi gjetur në një udhë për të cilën nuk dimë nëse ka fund ose jo. Njerëzimin dhe turmat e njerëzve, shekuj më parë i kanë kapluar ethet e përparimit, zhvillimit. Sot madje, një pjesë e madhe e njerëzimit duke mos menduar për domethënien e qëllimit, para tyre e "humbin" veten në mitin për "zhvillimin", "progresin" dhe "pasurimin". Shtresat më të larta, më të pasura të shoqërive që gjenden në skajin më të largët të zhvillimit, pyetjet e veta i parashtrajnë ndryshe nga të tjerët. Megjithatë, ata që janë vetëm një shkallë më poshtë prej tyre si qëllim parësor e kanë zgjedhur statusin e atyre që i shohin si më të lartë se vetja. Ai që nuk është "nga klika e më të pasurve" veten e konsideron si relativisht të varfër. Propozimi më tërheqës që qytetërimi i sotëm ua bën vendeve dhe grupimeve që dëshirojnë "të ngriten", të pasurohen dhe t'i arrijnë avantazhet e shtresave të fuqishme është ky: shpëtimi nga varfëria.

Nga perspektiva e vendit (shoqërisë – A.P.), shpëtimi nga vobektësia do të thotë: "fryrja" e barqeve të qytetarëve, ngrënia e tyre në sasi më të mëdha dhe ushqime më cilësore, ngritja e standardit të veshmbathjes, zotërimi i mallrave të konsumimit, pasurimi i çdo këndi të jetës me mallra, me aparate të llojllojshme, mbrojtja e shëndetit, dakordimi i qytetarëve me eksperimentimin mjekësor pas ç'do çekuilibri fizik, edukimi dhe arsimimi, përfitimi i çdo individi dituri me të cilat do të mund t'i shërbejë jetës që vazhdimisht shkon duke u bërë më komplekse, jeta pa brenga nga papunësia, lëvizja për të gjetur punë, ndierja e sigurisë nga rrjedha e jetës së përditshme dhe përsëri, moszotërimi i kurrfarë kapëseje konkrete... Numri i këtyre qëllimeve mund të shtohet, por një gjë është më se e vërtetë: qytetërimi përfundimor nuk i ofron ndonjë dimension tjetër njerëzimit.

Ky qytetërim edhe fitoren në tokat e veta e ka arritur duke ua bërë të dashura njerëzve qëllimet e sipërpërmendura. Misionarët e qytetërimit bile edhe në vendet e veta si në Angli, në Francë etj., e kanë përhapur bindjen se populli mund të shpëtojë nga varfëria vetëm duke u qytetëruar dhe modernizuar. Por, duke e realizuar një gjë të tillë kanë shfrytëzuar një dredhi dhelpërake, e kanë larguar nga mendja e njerëzve të vërtetën se vetë qytetërimi është një element që krijon varfëri. E kanë fshehur të vërtetën se për t'u realizuar misioni i qytetërimit duhet të shtypet një numër i caktuar i njerëzve, se duhet t'u merret e drejta për jetë disa njerëzve të tjerë. Nuk kanë treguar e as të tjerët nuk i kanë lënë të tregojnë se varfëria që lind pas bërjes së hapave të parë të qytetërimit mund të evitohet vetëm duke u kthyer mbrapa me hapat e njëjtë. Duke trumpetuar se shkaktar i varfërisë është të qenët i paqytetëruar, kanë arritur ta bindin një numër të mjaftueshëm të njerëzve. Kështu është kaluar në periudhën e parë. Periudha e dytë e përgatit ambientin e përshtatshëm për pasionimin e çdo vendi për t'u inkuadruar në çarkun që rrotullohet. Këto dy periudha në çdo vend janë përjetuar sipas kushteve specifike (të vendit gjegjës). Turqia sot është duke i jetuar fazat e fundit të periudhës së dytë.

Misionarët e qytetërimit edhe përkufizimin e qytetërimit e kanë bërë vetë dhe jashtë përkufizimeve të veta askujt tjetër nuk i kanë dhënë të drejtë fjale. Sipas tyre, varfëria është larg përsosurisë, kurse e përsosura është një zonë e fitimit material të cilës ende nuk është arritur. Me këtë përkufizim i kanë bindur edhe përkrahësit edhe armiqtë e vet. Pasi të besohet se gjëja e pritur nga jeta gjendet brenda kufijve të vizatuar nga misionarët e qytetërimit, nuk mbetet shkak pse të mos mashtrohemi me iluzionin e qytetërimit. Kurse varfëria nuk është asgjë tjetër pos përmallimit ndaj asaj që gjendet në duar të tjetërkujt. Nëse çështja kuptohet në këtë trajtë, vihet në përfundim se shpëtimi nga varfëria nuk

arrihet duke fituar diçka por duke e kuptuar atë me të cilën disponojmë. Ky është një përkufizim që i shqetëson misionarët e qytetërimit.

Mitet mbi zhvillimin, përparimin, modernizimin, pasurimin dhe forcimin, në kohën tonë më tepër i mashtrojnë vendet që përkufizohen si të pazhvilluara, të prapambetura, jo të modernizuara, jo të pasura dhe jo të fuqishme si dhe popullatën e këtyre vendeve. Mashtrohemi, sepse kjo përpjekje paraqet një përpëlitje e cila në rrugën e zhvillimit, pas një niveli të caktuar, e humb domethënien e vet. Këtë më së miri e kuptojmë nga përvojat që i ka përjetuar njerëzimi në shekullin XX. Se përparimi material nuk është me vlerë që meriton të jetë synim ose cak, më së miri tregon gjendja e vendeve të njohura si të zhvilluara.

ZBULIMI I JETËS

Librat mësimorë i japin një fotografi antipatike letërsisë, shkencave dhe shumë gjërave që meritojnë të mendohet për to. Kjo për arsye se edukata është institucion në kuadër të cilit - pa marrë parasysh suksesin dhe cilësinë - periudha më tërheqëse e shkollimit bëhet në saje të pasurimit të nxënësve/studentëve me disa gjëra jashtë procesit edukativo-arsimor se sa me specifikat brenda këtij procesi që zgjat vite me radhë. Suksesi i disa individëve në fushën në të cilën janë specializuar gjatë shkollimit, në të shumtën e rasteve është ngushtë i lidhur me të vërtetën se njohuritë e fituara gjatë shkollimit i kanë nxjerrë jashtë shkollës dhe në një farë mënyrë të njëjtat i kanë "jetësuar".

E njëjta vlen edhe për atmosferën e përgjithshme të pajisjes me njohuri. Njohuritë të cilat bëhen modë nga ana e mass medimeve shumë shpejtë fshihen. Thjeshtësohen dhe bien në pozitë të satisfaksionuesit të inteligjencës mediokre. Në këtë ambient, në skenë dalin njohuri që janë nuhatur nga intelektet e gjalla dhe nga ata që dëshirojnë ta ruajnë freskinë e shpirtit. Por, në fenomenin e kësaj rëndomtësie fshehet një gabim, sepse dijet dhe shijet e hapura ndaj pranimit të përgjithshëm për nga thelbi i vet mund të jenë ushqyese dhe karakteristika që në vete përmbajnë vitalitetin. Nëse është kështu, duhet që të ngrihen perdet që i japin mundësi jetës së banalitetit në kuadër të këtij produktiviteti, duhet të thyhet lëvozhga që e ngrinë inteligjencën, duhet të grisët rrjeti i pashpirtshmërisë që e inertëson ose ngurtëson dashurinë. Të gjitha këto na lënë ballëpërballë me domosdoshmërinë e rizbulimit të jetës.

Ndodh që të mendoni se thellimi në çështjen e kulturës, shkuarja larg në sferat origjinale të shkencës dhe artit janë të gjykuara me një budallallëk, pashijshmëri dhe pashpirtësi, sepse thellimi në dituri dhe subtilimi në art i kanë muret e veta të larta doganore. Në ato hapësira mund të hyhet vetëm në saje të harxhimit për hir të diçkaje dhe sakrifikimit të disa gjërave të dobishme. Përsëri duhet thënë se kjo metodë e shijimit që bazohet në parimin e elitizmit, nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me zbulimin e jetës, sepse në faturën e çmimit të përfuturit të kësaj kënaqësie gjendet edhe shkëputja prej njerëzve. Në kohën moderne kanë jetuar shumë "intelekte", emrat e të cilëve kanë mbetur në të nesërmen, që nuk kanë pasur asnjë mik e dashamir me të cilin do të mund ta përdornin dhuntinë e të folurit. Po, grupimet e njerëzve që përbëjnë botën e ideve dhe ndjenjave të larta janë ballafaquar me pranimin si normale të gjendjes së mosuksesit të krijimit të një komunikimi të ndërsjellë mes vete. Mund të mendojmë se as institucionalizimi e as ngritja e nivelit me qëllim të zhdukjes së ndikimit plogështues të shijes dhe inteligjencës mesatare, nuk është një rrugë 'shëruese'.

Atëherë pra, cila është rruga e zbulimit të jetës pa u vulgarizuar dhe pa u gjykuar në vetmi? Ose, a ekziston një rrugë e tillë? Menjëherë duhet theksuar se përgjigjet e hëpërhëshme të këtyre pyetjeve paraqesin përpjekje të standardizimit. Nëse pas personit që pohon se ekziston një rrugë e drejtë, i cili këtë rrugë e ka gjetur me anë të aftësive të veta perceptuese dhe rezonuese, del dikush tjetër dhe e sugjeron shkuarjen hapave të njëjtë, kjo do të thotë se gjendemi ballë për ballë rrezikut (nga i cili deri sot mjaft kemi çaluar) të nënshtrimit ndaj inteligjencës mediokre, ngrirjes së dijes dhe zyrtarizimit të shijes. Në rregull, por a thua nuk mund të thuhet asgjë në këtë temë? Mund, por kjo mund të jetë vetëm një pikëpamje e përgjithshme, sepse çdo individ rrugën që shpie kah zbulimi i jetës mund ta gjejë vetë, duke bërë hapa si individ. Nëse e bën një gjë të këtillë, e zbuluara është e tij dhe ia arrin mundësisë që nga ajo të shijojë kënaqësi të pafundtë.

Njëri nga botëkuptimet tona të përgjithshme, e ndoshta i pari, në rrugën që shpie kah zbulimi i jetës, është ai që gjendet në sferën ku thellohet ndjenja jonë rreth "jetës së përditshme". Nëse jeta jonë e përditshme është shkëputur nga idetë dhe ndjenjat që ne i shohim për sublime dhe të vlefshme dhe nëse pranë tyre është e pakuptimtë, para së gjithash duhet ndalur e menduar ca. Cila pjesë e jona është false? Vallë, vlerat tona që mendërisht i kemi pozicionuar në një pedestal të lartë ose jeta jonë që asnjëherë nuk mund të përputhet me nivelin e tyre? Nëse jeta jonë e përditshme nuk fiton në vlerë nga refleksionet e mendimeve, kjo do të thotë se jemi duke jetuar një jetë false. Nëse mendimet tona mbeten ngushëlluese karshi jetës sonë të përditshme, kjo do të thotë se kemi kokë false.

Zbulimi i jetës duhet të fillojë me përpjekjet për ta gjetur sublimen në jetën tonë të përditshme dhe me përpjekjet për jetësimin dhe aktualizimin e mendimeve tona sublime.

MOSREHATIA E DIJES

Fjala dije, nga aspekti i kuptimit që e përmbanë, është dykahëshe. Njerëzit mund të përftojnë dije të formës (trajtës) dhe dije të thelbit. Sot në të gjitha shoqëritë, në emër të dijes fjalën e ka dija trajtësore. Ndodh që shumica dërrmuese e njerëzve gjatë shekujve jetën e kanë çuar vazhdimisht me dijen trajtësore, kanë jetuar dhe vdekur duke zotëruar shumë pak nga dija thelbësore. Dija trajtësore nuk është një fushë e dijes që mund të përçmohet. Një fushë e gjerë e dijes, duke filluar nga dija se nga cili liman do t'i hipim anijes për të shkuar në shtëpi, dija për distancat ndërplanetare, dija se pirja e ujit të ftohtë duke qenë të nxehtë fizikisht do të na sëmuret e deri te skema e formimit të amino-acideve përfaqëson dijen e formës (dijen trajtësore). Lidhur me dijen e thelbit jemi lënë në një injorancë të thellë; kështu që mendojmë se përfitimet tona nga dija e formës dhe mundësia e përftimit të saj, na mjaftojnë për ta jetuar jetën me të gjitha ngjyrat dhe thesaret e saj. Në të vërtetë, ne duke mos qenë në vetëdije i përdorim në jetën tonë mjetet dhe fuqinë e dijes thelbësore, por meqë kjo gjendje është e mbuluar në zonën tonë të kuptuarit, nuk mund t'i themi vetes se disponojmë me dijen e thelbit.

Nëse duhet të bëjmë një përkufizim, do të thoshim se dija trajtësore është një dije që mund t'i përcillet tjetrit me anë të gjuhës. Mund të flasim edhe për parametrat dija thelbësore - gjuha, por dijen thelbësore me të cilën disponojmë nuk mund t'ia përcjellim askujt tjetër me anë të gjuhës. Dija thelbësore detyrimisht lind te njeriu dhe shfaqet në nivelin e tij të ndjenjave. Nëse njeriu nuk ka arritur që dijen e vet thelbësore ta përfitojë nga thelbi i vet, nëse nuk i bie në fije asaj, të njëjtën nuk mund ta mësojë me kurrfarë metode edukativo-arsimore. Mësimdhënësit nxënësve të vet mund t'u mësojnë vetëm subjekte lidhur me të njohurat (ma'lûmât). Disa tekste filozofike, disa libra të shkruar me qëllim të përcjelljes së urtësisë, mund t'i japin shenjat e dijes thelbësore, por kjo dituri është e karakterit të "dijes së ardhur", askush nuk zotëron fuqi me të cilën mund ta sjellë ose shpie. Përkundër gjithë kësaj, kushtet që e mundësojnë lindjen e dijes thelbësore brenda njeriut mund të jenë subjekt i transferit. Disa njerëz në saje të veçorive gjenetike mund të disponojnë me aftësi të caktuara; disa metoda të ushqimit dhe jetës, në masë të caktuar mund ta pengojnë shfaqjen e dijes thelbësore.

Njerëzimi sot po sillet e pështillet brendapërbrenda kornizave të dijes trajtësore, e cila na siguron njohuri të shumta në lidhje me formën e botës, funksionimin ekonomik, strukturën politike dhe teknologjike të saj etj.

Duke e menduar botën në kokën tonë përnjëherë mund të "ngjallim" harta. Zotërojmë dije hipotetike dhe praktike lidhur me vijat detare dhe ajrore. Po ashtu edhe dije trajtësore lidhur me të kaluarat e shoqërive, strukturën e materies. Jeta jonë e përditshme zhvillohet tërësisht në rezervë të dijes trajtësore. Nëse nuk e dimë vlerën e parasë, nëse nuk i dimë themelet trajtësore në kuadër të të cilave zhvillohet puna e njerëzve dhe sistemi shoqëror, nuk mund të mbetemi në jetë as 24 orë.

Ç'fatkeqësi që, privimi i njeriut nga dija thelbësore përballë grumbullit të dijes trajtësore shkakton një konflikt dhe konfuzion shumë të rrezikshëm. Si pasojë e faktit se dija trajtësore ka të bëjë me "lëvizshmëri" e gjërave ekzistente, me kufijtë e jashtëm të tyre, çdo njeri, tjetrin (domethënë atë që është jashtë vetes) së pari e konsideron të huaj e më vonë, në mënyrë suksese fillon ta konsiderojë si armik. Tash çdo gjë që ai e di trajtësisht, bëhet armiku i tij, sepse njeriu trajtësisht zotëron dijen e kufijve të aftësive të veta fizike dhe intelektuale. Përtej këtyre kufijve fillon "tjetri". Për këtë arsye mendjes i shkon për shtati që çdo gjë që e rrethon njeriun ta konsiderojë si të huaj.

Zotërimi i dijes trajtësore ka kuptimin e fillimit të mosrehatisë. Fjalët që qarkullojnë në popull, "njeriu do të ishte më rehat sikur të mos dinte", na tregojnë se dija për të cilën flitet është dije trajtësore. Njerëzit, si rrjedhojë e 'ngjitjes' së tyre pas dijes trajtësore, prehjen e kërkojnë duke u qëndruar afër gjërave që i kënaqin dhe duke u qëndruar larg gjërave dhimbjeshkaktuese, marrin qëndrim agresiv kundrejt realitetit jashtë aftësive të veta trupore dhe intelektuale. Te të njëjtit, mundja e natyrës, kapërcimi i kushteve të trupit njerëzor, marrja nën kontroll e njerëzve të tjerë, shfrytëzimi i një kombi tjetër, zhdukja e një kulture tjetër e kështu me radhë, kuptohen si kushte të ekzistencës. Bota moderne e cila dijen trajtësore e ka bërë kurorë, është një botë e garave, e konflikteve dhe përpjekjeve për zhdukjen e ndërsjellë. Qytetërimi bashkëkohor duke mos e vënë në përdorim dijen thelbësore, në kuadër të përpjekjeve për shpëtimin nga gjërat që i di për armik, do ta shtyjë veten në sferën e mosekzistencës. Të diturit e vetes për identitet të kufijve personalë, sjell me vete vetëm se kufizimin e tjetrit dhe një mosrehati që s'ka të sosur.

'Ngjitja' për dijen trajtësore njeriun e shqetëson. Disa, si rezultat i shndërrimit të kësaj mosrehatie në "aksion", e ngushellojnë vetveten. Individit që është thelluar në një jetë të punës aktive që e shkatërron trupin e tij, ai që orvatet që të menduarit e vet ta përdorë për qëllime ideologjike, mund të jetojë duke dhënë mund për ta siguruar ekzistencën pa i ra në fije faktit se është duke e munduar veten. Atë që bën një jetë hiper-aktive, ndoshta jeta e tillë e fut në një mosrehati fizike, por në disa çështje "që i përkasin shpirtërores" ndjen në vetvete njëfarë rehatie. Ky person aktiv ose kujton se disponon me një mekanizëm i cili do ta zë vendin e dijes thelbësore, ose nuk çan kokën për qenësimin ose mosqenësimin e një gjëje të quajtur dije thelbësore. Në të dy variantet, këta tipa që 'ngjiten' pas dijes trajtësore dhe aty mbesin, e degradojnë botën e vet shpirtërore. Nuk duhet harruar se shumica e njerëzve nuk mund të bëjnë jetë hiper-aktive. Sado që prodhimtaria makinerike i preokupon njerëzit në kohë të punës, ata kanë edhe kohën e tyre të lirë e cila është e hapur ndaj "mendimit, të menduarit".

Disa herë themi se kushtet bashkëkohore të punës janë të orientuara që njeriut t'ia plotësojnë me aktivitete plotësuese edhe kohën e lirë të tij. Zbavitjet, ahengjet, ndeshjet sportive dhe mass-mediumet njeriun e detyrojnë që bile edhe në kohën e lirë të merret me dijen trajtësore. Zbavitjet dhe sporti janë në kuadër të dijes trajtësore si pasojë e të qenët të tyre lojë. Lojërat, kushtet e të cilave janë të paracaktuara, të cilat marrin kuptim nëse i pranoni rregullat e tyre, nuk janë asgjë tjetër pos "lëshim vullnetar i vetë njerëzve vetveten në një mashtrim". Lojërat, për të qenë qetësuese, e çlodhëse, duhet të kenë një sharm ose tërheqshmëri që do ta preokupojnë njeriun. Por, njeriu kur e kupton se është çlodhur nga preokupimi me x lojën, bie në një disharmoni të themeltë. Nëse zbavitet për ta ngushëlluar veten, sapo të fillojë të mendojë rreth pyetjes "vallë pse dëshiroj ta ngushëlloj veten?" e pret një mosrehati, një shqetësim. Njeriu mundohet ta evitojë 'ngjitjen' pas formës me një metodë ose rrugë trajtësore. E kjo e shpie deri te të kuptuarit se rruga e zgjedhur për ta gjetur rehatinë është vetë fillimi i mosrehatisë.

Edhe karakteri zbavitës i mjeteve të komunikimit masiv mund të marrë formën inverse. Njerëzit që i janë hapur botës por që marrin vetëm njohuri të karakterit trajtësor, shtypen nga gërmadhësia e këtyre njohurive. Kjo shtypje është ka dy pole: Shqetësimin që buron nga pozita e vogël që e zë njeriu përballë shumëllojshmërisë dhe pluralitetit dhe mosrehatinë që buron nga e vërteta se jetën e tij e determinojnë disa njerëz që nuk kanë ndonjë dallim cilësor ose epërsi nga ai vetë. Që njeriu të mos shqetësohet nga të dhënat ose njohuritë trajtësore që i servojnë mjetet e komunikimit masiv, duhet t'i pranojë kushtëzimet që i servojnë të njëjtat, gjegjësisht të mos i bie në të realitetit se është

kushtëzuar. Atëherë kjo do të thotë se njeriu e ka pëlqyer një jetë trajtësore tepkë si dija trajtësore që i është servuar atij, gjë kjo e cila (për të - A.P.) nuk ka ndonjë aspekt shqetësues.

Mass-mediumet bëjnë fjalë për inflacionin, veprimtaritë në sferën e astronomisë, inzheneringun gjenetik, luftën bërthamore, metodat edukativo-arsimore, ato të kurimit etj. Njeriu i pajisur me dije trajtësore nuk është i sigurt nga paraja që e ka në xhep, nuk është i sigurt nëse nesër qyteti në të cilin jeton do të shkatërrohet me një predhë ose jo, nëse ilaçi që e ka marrë kundër gripit do t'ia shkaktojë kancerin ose jo, nëse fëmija i tij do t'i njohë vlerat e veta ose jo, nëse do ta ruajë ose jo nesër stilin jetësor të sotëm...! Ata që e servojnë dijen trajtësore, me të vërtetë nuk janë të informuar për ndikimin e kësaj dijeje mbi njeriun. Vetë ata, pa marrë parasysh në krye të cilit ujë gjenden, medoemos kanë mësuar se jeta nuk rrjedh vetëm në saje të ujit në krye të të cilit gjenden vetë, kanë mësuar se edhe ata që përdorin një fuqi të caktuar, duke e kryer atë punë kanë hyrë në suaza të asaj fuqie. Dija trajtësore e shpie në mosrehati edhe dhënësin edhe marrësin e saj.

ILUMINIZMI

Qytetërimi perëndimor, në korniza të kritereve të veta, shekullit XVIII të erës së re ia dha emrin "Shekulli i Iluminizmit". Në atë kohë, për evropianët bota ende ishte identiteti i Kontinentit të Vjetër (Evropës). Për pasojë, besonin se drita gjendej tek ata dhe se pikërisht ata do ta ndriçonin pjesën tjetër të rruzullit tokësor. Kjo është periudha kur Evropa bëri hapa të mëdhenj në rrugën në të cilën kishte hyrë, kur ajo kish arritur suksese të çmuara në fushë të shkencës dhe filozofisë. Në të vërtetë, rruga në të cilën kish hyrë Evropa as në aspektin kohor as në atë përmbajtësor nuk ishte "e freskët", por kishte shumë shpresa që e lehtësonin pranimin e të njëjtës si "rrugë e re". Ende nuk mund të parashikohet se në ç'labirint do t'i shpie njerëzit mendimi iluminist, se ç'destruksione do të shkaktojë për njerëzit e çdo klase dhe race. Faktori që e bëri të ri dhe të fortë mendimin iluminist, ishte tërësia e paramendimeve dhe iluzioneve nga të cilat ndjenin kënaqësi borgjezët e Londrës dhe Parisit.

Shekulli XIII është koha kur Roger Bacon-i ligjëronte në universitetin e Oksfordit duke qenë i veshur me veshje arabe. Në bisedat e tij filozofike temë dite e kishte veprën e Shejh Shihâbuddîn Jahjâ Suhreverdî-t Hikmetu'l-ishrâk (Urtësia e iluminacionit). Sipas R. Baconit përvoja është dykahëshe: E para, eksperimentet tona që i bëjmë me ndjenjat e jashtme (per sensus exteriores), kurse e dyta përvoja e brendshme që bazohet në frymëzim (inspirim), të cilën ai e quan scientia interior (shkenca e brendshme) e vërtetë. Sipas R. Baconit, iluminacioni që vjen nga Zoti është aspekti më i rëndësishëm i përvojës së brendshme në gjendje të raptus-it (ekstazës). Por duhet të kalonin pesë shekuj që Evropa fjalës iluminacion t'i jepte një domethënie specifike. Kuptohet se duhet pasur parasysh edhe ndikimin e ndryshimeve shoqërore, politike dhe ekonomike (të ndodhura gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore) mbi stilin jetësor dhe botën e mendimeve të njerëzve që kanë jetuar në këtë periudhë. Si përfundim Evropa u stacionua në mendimin iluminist ku dominonte dualizmi kartezi. Evropianët, përderisa shekullin XVIII e emërtuan si shekull i iluminizmit, nuk e merrnin për bazë "iluminacionin" por "dritën" e iluminizmit që sigurohej në saje të logjikës, eksperimentit dhe vrojtimit. Sipas premisave të qytetërimit perëndimor drita lindte nga jashtë duke u falënderuar shpjegimeve mbi metodat e rezonimit (rregullat e të cilave janë të njohura), mbi fenomenet që janë objekt i përvojës së jashtme dhe ndryshimeve që mund të vrojtohen. Sipas tyre, dija nuk pranohej si një gjë e harmonizuar me thelbin e njeriut, ajo dilte në shesh me një identitet impersonal (pavetor). Çdokush "mundte të dijë". Mjaftonte të tregojë fuqi për prezentimin e dijes së vet me metoda të pranueshme.

Nuk kaloi shumë kohë dhe u kuptua se rruga e dijësimit të cilën qytetërimi perëndimor e quajti "iluminizëm" nuk arriti ta ndriçojë as njeriun e as botën. Në shekullin XIX dhe XX u kuptua se shkenca dhe filozofia, se rregullat e metodave logjike nuk e siguruan iluminacionin e vërtetë, u kuptua se të diturit (dituria) është ngushtë i lidhur me të diturin ose atë që di. Sot në veçanti në lëmin shkencor të quajtur fizika e energjisë së lartë, thuhet se deri te dija mund të arrihet vetëm në saje të shndërrimit të njeriut në njësi të vrojtimit dhe të eksperimentimit. Mund të thuhet se shkenca perëndimore po përjeton një tronditje të thellë, se dualizmi kartezi e ka braktisur ndarjen e tipit "ai që di" - "gjëja e ditur" (e njohur).

Por, ndikimi i pikave deri te të cilat është arritur si rrjedhojë i zhvillimit të shkencës është më i madh sesa ai i periudhës së "adoleshencës" së saj (shkencës). Sot, struktura e përgjithshme e vazhdon botëkuptimin i cili e çoi në qorrrokak qytetërimin perëndimor.

Njerëzit ende vazhdojnë të jetojnë duke treguar respekt ndaj bestytisë, legjendës për përfitimin e diturisë objektive. Bota jonë nuk ka hyrë nën flatrat e udhëheqjes së njerëzve që e kanë kuptuar dhe vepruar në përputhshmëri me iluminacionin. Pse?

Mendoj se përgjigjja e kësaj pyetjeje drejtpërdrejtë ka të bëjë me mjetet që i përdorim gjatë sistematizimit të jetës sonë. Ne, sado që nga prizmi i gjendjes mendore i afrohemi të drejtës, sado që në saje të ndonjë përfundimi të çuditshëm e kuptojmë se dija është pjesë e pandashme e njeriut, prapëseprapë jetën tonë të përditshme e rregullojmë me një stil të varur nga mjetet dhe veglat e qytetërimit perëndimor, jetojmë nën hijen e tyre dhe brenda kufijve të ngushtë të mundësive të tyre. Shkenca e kuptoi se dija nuk mund të fitohet në laborator, por ç'e do që edhe këtë e kuptoi përmes laboratorit. Sikur që kundërtia e jetës sonë nuk mund të injektohet brenda jetës sonë, ashtu edhe e vërteta lidhur me thelbin e dijes nuk mund të përfitohet duke e braktisur dijen.

Ç'mund të bëhet? Nëse iluminacioni është përfundim deri te i cili mund të arrihet përmes një shkëndije që vjen nga brendia e njeriut dhe duke mos i sakrifikuar të arriturat nga bota e jashtme, e vetmja gjë që duhet bërë është konceptimi (kuptimi) i vetëdijshëm i rezultateve të këtyre dy aspekteve. Qytetërimi perëndimor edhe duke e çuar veten në qorrsoak edhe duke i shembur elementet që i mori nën ndikimin e vet, besonte në epërsinë absolute të dijes që ka të bëjë me "të jashtmen" (eksternen). Muslimanët dhe vetëm ata mund t'i japin shembujt e baraspeshës së bekuar ndërmjet eksternes/ekzoterikes (dhâhir) dhe internes/ezoterikes (bâtin). Vetëm ai që është ndriçuar në botën e tij të brendshme mund t'i japë shkëndijë botës së jashtme.

FEJA E QUAJTUR HUMANIZËM

David Ehrenfeld thotë: "Humanistët e sulmojnë fenë duke e marrë për pretekst faktin se e njëjta përmban hipoteza që nuk janë objekt i eksperimentit, por edhe vetë humanizmi përmban të tilla (hipoteza që nuk janë objekt i eksperimentit). Këto hipoteza pranohen si data (të dhëna), vihen në vendin e vet me një pranim jashtëvetëdijësor, shumë rrallë ose fare nuk polemizohet rreth tyre. Humanistët botëkuptimet etë tjerëve që janë të ngjashme me hipotezat e veta, përnjëherë i emërtojnë si bestytini. Ose, duke treguar xhentilitet thonë: 'Këto gjëra janë temë e besimit'. Hipotezat e humanistëve meqë nuk mund të bëhen temë e eksperimentit dhe nuk mund të ekzaminohen, paraqesin fjali të formuara nga shprehje të shkurtëra, si p.sh. $2 \times 2 = 4$.

Sa specifikat lidhur me rrethin po aq edhe hipotezat themelore humaniste që i përfshijnë të gjitha subjektet, janë mjaft të thjeshta. Humanistët, mes tjerash, thonë:

- Çdo çështje ka zgjidhjen e vet. (Domethënë nuk ekziston çështje e pazgjidhshme).

Për ta shprehur më qartë lidhjen e kësaj hipoteze me Humanizmin, nëse formojmë një fjali duke ia shtuar shprehjes së cituar fjalën njeriu. Kështu lind hipoteza në vijim:

- Njeriu mund t'i zgjidhë të gjitha çështjet.

Ekzistojnë edhe hipoteza tjera të Humanizmit, që janë edhe më pretencioze se hipoteza themelore, por fuqinë e kanë më të dobët. Në kuadër të këtyre hipotezave dytësore bëjnë pjesë këto:

- Shumë çështje zgjidhen me "dorën" e teknologjisë.

- Çështjet e pazgjidhshme me anë të teknologjisë, ose çështjet për zgjidhjen e të cilave fuqia e teknologjisë është e pamjaftueshme (nga fusha e politikës, ekonomisë etj.) zgjidhen në suaza të botës shoqërore.

- Nëse zgjidhja e arritur përfundon me shkatërrim, pa humbur kohë e programojmë veten për një zgjidhje tjetër; të bashkuar do të mundohemi të arrijmë deri te ajo.

- Disa resurse nuk kanë të sosur, ekziston mundësia edhe për zgjatjen e jetës së resurseve për konsumim. (Në këtë rast bëhet fjalë për burimet e energjisë).

Qytetërimi njerëzor do të jetojë".

Kjo që e cituam deri tash, sipas një autori, i paraqet themelet besimore ose credo-n e "fesë së humanizmit". Por, siç shihni edhe ju, gjykimet të cilat këtu prezentohen si hipoteza të humanizmit, nuk e kanë zgjidhur në veçanti të qenët humanist. Këto hipoteza pranohen "pa pse" edhe nga shumë njerëz të cilët veten e konsiderojnë si pjesëtarë të njërës nga 'fetë e librit'. Shumë persona të cilët pohojnë se janë muslimanë, jetojnë duke u mbështetur haptas ose fshehurazi në gjykimin "çdo çështje ka zgjidhjen e vet".

Feja e humanizmit, që nga fillimi veten e ka gjetur përballë një "çështjeje". Humanisti pasi që nuk i beson transcendentales dhe pasiqë nuk pranon se udhëheqësia sigurohet me një fuqi mbi kapacitetin e vet, vetveten e sheh si një zgjidhjeprurës. Për këtë arsye është i detyruar që para vetes të "krijojë" çështje (probleme).

Për humanistin njeriu që e pret ose që shpreson në shërimin nuk ekziston fare. Së pari ekziston sëmundja, d.m.th. "çështja". Këtë çështje e ka për obligim ta zgjidhë njeriu.

Humanistët e pranojnë realitetin e ekzistimit të të pasurve dhe të varfërve, por e kanë mbyllur mendjen para idesë se të pasurit janë të ngarkuar t'u ndihmojnë të varfërve. Për ta, së pari ekziston çështja e "varfërisë" dhe zgjidhjen e saj e presin nga njerëzit. Gjendja nuk ndryshon madje edhe nëse varfëria, e cila trajtohet si një çështje, vazhdon duke e ndryshuar gradualisht karakterin e vet.

Për humanistët ekziston çështja e "dijes". Humanistët nuk e përfillin të vërtetën se me zbritjen e dijes në shkallë të çështjes, nuk njihet natyra e vërtetë e saj.

Humanisti, i cili e konsideron veten si njeri i obliguar të shkaktojë çështje, është bërë sakrificë e shkurtpamësisë, sepse horizonti i tij i momentit kur ka dalë në rrugë e ka përcaktuar botëkuptimin e tij. Ai kujton se duke menduar se do të merren masa eksplicite kundër sëmundjeve infektuese, analfabetizmit, kundër varfërisë dhe këmbëzbathurisë, "çështja" do të zgjidhet dhe do të arrijë të dominojë me masat e marra në këta lëmenj. Kurse kjo nuk është asgjë tjetër pos refleksion i qëndrimit fëmijëror evropian se në vendin ku bashkohen ylberi dhe toka gjendet një kovë me flori dhe me margaritarë.

PJESA E JASHTME E RRETHIT

A thua interpretimet e muslimanëve lidhur me ngjarjet politike, pa marrë parasysh qëllueshmërinë e tyre, kanë ndonjë vlerë të madhe ose jo? A thua u mjafton muslimanëve për të marrë një "qëndrim muslimançe" (ose qëndrim islam) pajisja me dituri bazore dhe përfshirëse rreth evenimenteve politike, strukturës shoqërore, formës që ka marrë kapitali dhe mendësisë së njerëzve? Pra, nëse muslimanët e dinë hapur dhe qartë kuptimin e politikës botërore ndaj tyre, nëse dinë se nga cila dobësi mund të përfitojnë, fuqinë materiale të kujt mund ta përdorin, a do të mund të veprojnë ashtu siç u ka hije atyre (muslimanëve) dhe të zhvillojnë aktivitetin e duhur për t'i orientuar njerëzit kah njëshmëria (tevhîd)? |

Në kuadër të qëndrimeve dhe sjelljeve të muslimanëve gjendja e kushteve botërorë në një kohë të caktuar paraqet vetëm pjesën e jashtme të rrethit. Por nuk duhet harruar se pjesa e jashtme e rrethit mund të vizatohet vetëm kur rrethi ka një epiqendër. Nëse pikat që janë në largësi të barabartë ndaj pikës qendrore nuk mund të bashkohen, kjo do të thotë se rrethi nuk ekziston. Nga ana tjetër, madje edhe nëse nuk ekziston qendra, ekziston një formë e caktuar, por kjo formë nuk është rreth.

Shkurtimisht, për të marrë një qëndrim islam, së pari duhet fiksuar qendrën. Nëse kjo qendër ka një pozitë konkrete lidhur me të jashtmen, atëherë mund të kuptohen vetëm faqet ose anët e dukshme të ngjarjeve, karakteri i tyre manifest. Atëherë pra, kur themi qendra, nëse kemi për qëllim një zonë të të konceptuarit, do të thotë se kemi bërë një fiksim të qëlluar.

Ana manifeste e kësaj qendre konceptimi janë lidhjet e muslimanëve me Kur'anin dhe Sunnetin. Nëse tërësia e vlerave të çdokujt është formuar në një konstrukt që për bazë e merr këtë qendër, vjen deri te lehtësimi i marrëdhënieve ndërmjet muslimanëve dhe nuk lindin probleme.

Qendra në fjalë në të njëjtën kohë është vendburim i një autoriteti, është vendmbështetje e autoritetit. Marrëdhëniet dhe lidhshmëritë e çdo muslimani me besimtarët tjerë islamë mund të maten me shkallën e lidhjes së tyre me qendrën.

Krahas të gjitha këtyre, besimi i tyre se disponojnë me pasuri që është përhapur në të gjitha anët, kuptimi i plotvetëdijshtëm i tyre se këtë pasuri e ndajnë me tjetrin, duhet që të vërtetohen edhe në jetën praktike edhe në atë ideore (në sferën e botëkuptimeve). Nëse qendra do të bëhet pikënisja e sjelljes islame, është e domosdoshme që të jetë e fuqishme deri në shkallë të gjenerimit të energjisë.

Kufijve të jashtëm të rrethit radha u vjen vetëm pas përfitimit të kësaj qendre, pas bindjes së plotë në ekzistencën e saj. Atëherë nga këndvështrimi i kushteve botërore e ambientale gjendja në të cilën gjenden muslimanët fiton në vlerë. Ky rregull nuk mund të kthehet në anën e kundërt (inverse). Domethënë nuk mund të arrihet deri te qendra, deri te fusha e konceptimit dhe zona e besimit duke filluar nga ngjarjet, interpretimet dhe kufijtë e jashtëm të rrethit.

Muslimanët nuk duhet që së pari të mësojnë se ç'shpërsh politika botërore e pastaj të bëjnë llogarinë se ç'është sjellja islame. Së pari duhet t'i përvetësojnë sjelljet islame, gjegjësisht ta gjejnë qendrën për të vepruar dhe t'i shikojnë pozicionet e tyre në arenën e politikës botërore.

Sikur sjellja islame të ishte vetëm e karakterit shoqëror, dhe të konsiderohej si qëndrim i kufizuar me subjekte si prosperiteti dhe pavarësia e një grupi muslimanësh, atëherë pjesa e jashtme e rrethit do të ishte e mjaftueshme për ne. Kurse e vërteta është se Islami është

besim, tërësi e botëkuptimeve dhe sjelljeve që u referohet kushteve të ekzistencës dhe kur këtë nuk e bën edhe vetë nuk ekziston. Muslimanët mund të marrin qëndrim islam dhe të sillen islamikisht vetëm nëse shpëtimin e të tjerëve e konsiderojnë si pjesë përbërëse të shpëtimit të vet. Kështu ka qenë më parë dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

FATURA E DHIMBJEVE

Njëri nga personalitetet e famshme të Revolucionit Francez, Dantoni, kur revolucioni filloi t'i përbijë fëmijët e vet, u dënua me vdekje. Rrëfëhet se Dantoni duke shkuar në gjyotinë xhelatit të vet ia pat thënë këto fjalë:

"Pasi që koka ime të ndahet nga trupi, tregoja turmës, sepse është një kokë që meriton të tregohet".

Në këto fjalë ndoshta gjejmë një shprehje elokumente të humanizmit që e ka plotësuar zhvillimin e vet në botën perëndimore dhe e kuptojmë faktin pse perëndimori (madje edhe sot e kësaj dite) e ka hyjnizuar veten dhe si me lehtësi i ka futur ndërmjet zotave të tij afinitetet e veta mendore. Nga këto fjalë mund të derivojmë edhe një kuptim tjetër, edhe një gjykim i cili mund të bëhet mbështetës i një pikëpamjeje morale: Një kokë nëse do të pritët duhet të jetë e vlefshme për t'u prerë. Pas prerjes së saj duhet të ekzistojë mundësia që të thuhet "Ja, kjo ishte koka që u pre"; "Ne e ndamë një kokë të tillë nga trupi".

Kjo nuk është vetëm një çështje e kokës. Çështje e disave ka qenë edhe sjellja e trupit në status që të kihet parasysh përballë vdekjes. Njëri nga ata që sa kokës po aq rëndësi i ka dhënë edhe trupit është shkrimtari japonez Yukio Mishima. Autori në fjalë, ishte i mendimit se jetën duhet jetuar dhe përfunduar në pajtim me traditat japoneze, se duhet jetuar dhe vdekur në mënyrë japoneze. Mishima në kohën kur i ka shprehur këto mendime ka pasur një trup mjaft të dobët. Ka menduar se trupi i dobët nuk vlen që të mbytet. Menjëherë i është rrekur punës, e ka zhvilluar trupin e vet dhe me një konstruksion atleti e me muskuj të zhvilluar ka arritur një dukje fizike të ngjashme me atë të samurajëve. Siç e dini Mishima, meqë nuk arriti sukses në thirrjen e tij drejtuar popullit japonez që të ngrihet në kryengritje për t'iu kthyer traditave japoneze bëri harakiri (vetëvrasje). Me të vërtetë a ka pasur kokë dhe trup? Për këtë çështje vendosni ju.

Në kontekst të këtyre mendimeve përpara na dalin pyetje të shumta. Ndalesh pak dhe sheh se njëri brohorit: "Unë e jap shpirtin për hir të kësaj ose asaj kauze". Atëherë atij personi, sikur që u pyet nëse Dantoni kishte kokë e Mishima trup, duhet parashtruar pyetjen nëse ka ose jo shpirt. Duhet mësuar nëse ai di ose jo se ç'do të thotë ta japësh shpirtin, nëse e ka idenë se ku gjendet shpirti? Domethënë, kur ai person thotë "e jap shpirtin", parashtrohet pyetja çka zotohet të japë ai njeri? A thua duke e dhënë atë (shpirtin) ç'dëshiron të marrë? A thua e ka dhënë më parë shpirtin (ose gjënë të cilën e vë në vend të shpirtit)?

Jeta dhe vdekja janë dy koncepte që e shpjegojnë njëri-tjetrin, meqë vlera e njërit mund të kuptohet në sajë të tjetrit. Ndoshta do të klithni: Sa është e drejtë që për jetën dhe vdekjen të flitet si për dy koncepte? Për njerëzit bashkëkohorë vdekja është një "koncept" ekzistenca ose mosekzistenca e të cilit mund të diskutohet? Por, a mund që jetës, e cila mund të perceptohet dhe ndjehet, t'i ngjitet emri "koncept"? Të mos dyshoni fare! Në çdo kohë, në ç'do shekull dhe në çdo klimë, jeta për njeriun ka qenë një koncept, një nocion. Por konceptualizimi i jetës varet nga individi, koha dhe vendi. Sipas disave, fuqia e palëkundshme e despotizmit e ka lindur shprehjen "të jetosh nën hijen e rrezikut të vdekjes". Por, koncepti i jetës të cilin sot e bartim në kokat tona për t'iu zotuar një pune pro të drejtës dhe të vërtetës, nuk na detyron që në mënyrë absolute të ecim "nën hijen e rrezikut të vdekjes". Tanimë kemi një koncept të jetës që di se vendi i kokës nuk është kolltuku i vdekjes por pozicioni midis dy shpatullave. Atëherë pikëpamja jonë rreth vdekjes do të jetë e një vlere që është në pajtim me të.

Sot nuk është e duhur që njerëzit ta "fusin në rrezik kokën e tyre". Duhet bërë përpjekje që koka të mbahet në vendin e vet, d.m.th. mbi shpatullat. Nëse njeriu e ka kokën aty ku duhet të jetë, "shkuarja" e asaj koke bëhet e rëndësishme. Nuk është aspak e rëndësishme kah e kanë drejtuar kokën e vet ata që e kanë ndarë atë nga vendi i duhur, që nuk e kanë parë të duhur që ajo të qëndrojë mbi shpatulla, sepse, fundja e kanë zhvendosur atë dhe sipas të gjitha gjasave do ta kishin harruar dikund.

Përpos kësaj në mënyrë të qartë duhet ditur qëllimin pse përjetohen dhimbjet dhe vuajtjet. Nuk mjafton që me fjalë të thuhet "luftoj për hir të x kauzës", madje një gjë e tillë është e panevojshme. Ju do të jetoni dhe silleni asisoj, që nuk do të ketë nevojë të deklaroni se cilën çështje e keni marrë përsipër. Veprat tuaja do ta tregojnë qëllimin pse u jeni rrekur disa gjërave të caktuara. Shumë më me rëndësi është që mendimet tuaja të shfaqen përmes gjuhës së veprave e sjelljeve sesa të shprehen me shkrim ose me gojë. Gjendja në të cilën jeni është më e pasur me shprehje sesa gjendja të cilën mundoheni ta shpjegoni me fjalë ose shkrim.

Nëse individi që sakrifikon disa gjëra për hir të mendimit dhe besimit përpiqet ta tubojë rendimentin e vuajtjeve të përjetuara, mund të themi se në shkallaren e tij në rend të parë nuk janë as mendimi i tij e as besimi. Nëse veprës suaj që quhet flijim ose sakrifikim, nëse pas veprave tuaja të kryera del në pah një faturë, kjo do të thotë se veprat tuaja janë kryer vetëm për hir të kundërvlerës së kësaj bote dhe se keni bërë një punë, kundërvlera e së cilës mund të tregohet vetëm në faturë.

ATA QË DINË TË JETOJNË DINË EDHE TË VDESIN

Ndjenja e botës së përhershme (ahiretit) është busullë e sjelljeve të muslimanit. S'ka mundësi të quhet musliman njeriu që vepron pa mos e marrë në konsideratë llogarinë e botës tjetër. Por një e vërtetë që e dimë të gjithë është se muslimani statusin e vet në botën e ardhshme e përcakton me veprat e veta të kësaj bote. Nga kjo vijmë në përfundim se jeta e dynjasë është kuptimplotë dhe frytdhënëse. Është e pamundur të përgatitesh për ahiretin duke u qëndruar në distancë dimensioneve dhe çështjeve të jetës së kësaj bote, është e pamundur të disponosh me disa gjëra në botën e pafundme duke mos i ndërtuar disa gjëra në botën e përkohshme.

Në të shumtën e rasteve jetojmë duke mos e vënë në hesap të vërtetën se shumanshmëria e jetës sonë dhe pasurimi i strukturës sonë shpirtërore e rrit/pasuron konceptin tonë për botën tjetër dhe e shton lidhshmërinë tonë ndaj këtij koncepti. Jeta në nivel e besimtarëve muslimanë, përsosja e moralit, shkuarja e tyre kah kompaktësia e mendimit, orientimi kah disa konceptualizime të thella, përkapja e tyre e periudhës kohore në të cilën jetojnë në përputhshmëri me thelbin e saj, janë parakushtet e përkufizimit autentik të tyre të vdekjes. Edhe rruga e mësimin të domethënies së jetës dhe vdekjes nga Kur'ani Famëlart, drejtpërsëdrejti kalon nëpër të kushtuarit rëndësi jetës personale dhe lidhshmërisë së qenies së njeriut me njerëzit tjerë. Të kuptuarit se jeta vlen të fitohet, është derë e hapur për të kuptuar se edhe ahireti vlen të fitohet. Përfytyrimi lidhur me dynjanë e përcakton përfytyrimin lidhur me ahiretin, vice versa.

Fjalët e llojit "flijimi i jetës", "vdekje për hir të një kauze ose besimi", që shpesh i stolisin majat e gjuhëve, duhet vlerësuar horizontalisht dhe vertikalisht nga këndvështrimi i raportit tonë me jetën, duhet pozicionuar në një botëkuptim të caktuar. Sipas botëkuptimit tim, për t'u flijuar një jetë duhet që krijesa përkatëse e gjallë dhe e ndjeshme ta çmojë jetën e vet. Është absurde ta flijojë jetën një njeri që nuk e çmon jetën e vet, që beson se nuk ka vend në këtë botë. Paramendoni, ai jetën e vet e konsideron si gjë që s'vlen për asgjë, si një gjë, qenia dhe mosqenia e së cilës janë të barabarta; kur ky thotë se e ka flijuar ose do ta flijojë jetën e vet, nga ç'vlerë dhe pasuri heq dorë? Vdekja është një koncept tepër kuptimngushtë për atë person që përgjatë jetës së vet në vend të pasurimit të botës së brendshme e ka zgjedhur shterpëzimin e saj, në vend emocionimit përballë të mirës e ka zgjedhur indiferencën ndaj të mirës e të keqes, në vend të ndjeshmërisë përballë ngjarjeve natyrore dhe shoqërore e ka zgjedhur automatizimin. Për atë person, vdekja ndoshta nuk ka kurrfarë kuptimi.

Ne si muslimanë, sikur që jemi të detyruar që rrjedhën e jetës sonë ta nxjerrim nga pozita e të qenët mekanike, po ashtu jemi të detyruar që funksionimin e jetës sonë ta bëjmë të shumanshëm dhe të përshtatshëm, me qëllim që morali islam me lehtësi të gjejë vend në strukturën tonë. Qytetërimi i sotëm nën sundimin e të cilit jemi duke jetuar, mundohet të na sjellë në pozitën e njerëzve me ndjenja dhe mendime ditore dhe të njerëzve, vlerat e të cilëve janë identike me vlerat mekanike të turmës. Mund të thuhet se në këto përpjekje nuk është aq i pasuksesshëm. Apologjetët e botëkuptimeve djallëzore të cilët e dinë se të kuptuarit e jetës me gjithë thesarin e saj do e s'do do ta ruajë të gjallë ndjenjën për botën e ardhshme, duan t'i gjykojnë muslimanët që edhe ata, sikurse edhe njerëzit tjerë, të mbeten të thelluar në disa shabllone shterpe të mendimit.

Edhe përkundër kësaj ne do ta bëjmë të vlefshme jetën tonë Çdonjëri prej nesh, nga aspekti i aftësive që i kemi zhvilluar do të kahëzohemi kah të qenët nga një thesar, ashtu që, një ditë kur do të duhet që për hir të Islamit ta japim jetën, të mund të sakrifikojmë

thesare; zotimi për ta dhënë jetën të mos e ketë kuptimin e heqjes dorë nga mjetet e thjeshta të kënaqësisë. Nëse perëndojmë, le të perëndojmë si diej.

PËRFITIMI I MENDJES

Në shekullin tonë, zotërimi i muslimanëve i një konstrukti të shëndoshë shpirtëror dhe bonsens, është më i rëndësishëm nga zotërimi i këtyre elementeve në shekujt e kaluar. Kjo, për arsye se bota në të cilën jetojmë është "themeluar" si rrjedhojë e vënies në aplikim shumëshekullor të një programi të kushtëzimit sistematik. Çdokush që nuk e ka humbur aftësinë e të menduarit, me lehtësi kupton se në kohën tonë kushtëzimi është më intensiv dhe më i ndikueshëm. Me përparimin e mjeteve të komunikimit masiv njerëzit më lehtë i përtypin sofisteritë, informacionet e qëllimshme, emocionet e komprimuara etj. Në shekujt e kaluar përmes librave dhe mësonjëtove, recipient i kushtëzimeve ka qenë vetëm një numër i kufizuar i njerëzve, kurse sot shënjestër e tyre (kushtëzimeve) në saje të internetit, videos, televizionit, radios, kinemasë, teatrit, është tërë njerëzimi.

Për këtë arsye, lirisht mund të themi se në mendjen e çdokujt janë hapur vrima. Kur'ani Kerîmi na urdhëron të mendojmë, kurse sot mendja jonë po bombardohet aq ashpër saqë të menduarit duke e përdorur mendjen është një çështje në vete. Nëse pranojmë se ekziston një rrugë e mendimit të shëndoshë, duhet që t'u përgjigjemi edhe pyetjeve çka dhe pse mendojmë, ta inspektojmë çështjen nëse e përdorim ose jo "racionalisht" mendjen tonë. Do ta pyesim vetveten se a thua të menduarit tonë në këtë trajtë është detyrim i disa kushtëzimeve, ose kemi arritur që ta ruajmë shëndetin e mënyrës së të menduarit? Nëse pranojmë se në stilin tonë të të menduarit luajnë rol disa kushtëzime, duhet të kuptojmë se për çfarë kushtëzimesh bëhet fjalë dhe të tregojmë zgjuarsia që mos të biem edhe një herë në kurthin e njëjtë.

Ç'kuptim ka ruajtja e shëndetit të mënyrës së të menduarit? Nëse njeriu mënyrën e të menduarit e gjenë te ndikuesit si familja, shkolla, rrethi, vendi i punës, evenimentet shoqërore, të gjitha këto a nuk paraqesin kushtëzime të ndryshme? Pra, a thua e kemi ruajtur shëndetin e stilit tonë të të menduarit nëse e heqim mënjandë kushtëzimin e mass medimeve dhe nëse i pëlqejmë kushtëzimet e pranishme në lëmenjtë tjerë të jetës shoqërore? Përgjigjja është: Jo, assesi. Kjo do të thotë zëvendësim i një gabimi me një gabim tjetër. Deri te mendimi i shëndoshë mund të arrihet duke iu mbështetur disa aftësive të cilat njeriu i bartë me vete që nga lindja. Këtë, a mund ta quajmë intuitë? Jo. Nëse bëhet një emërtim, edhe mendimi i drejtë nuk mbetet në pozicionin e të qenët i drejtë. Çështja themelore ka të bëjë me atë nëse njeriu dëshiron ta mashtrojë ose jo vetveten. Te çdo njeri ekziston potenciali mendor për ta dalluar të vërtetën. Por ky potencial nuk është nën timonin e njeriut. Njeru nuk e bart në dorë të vërtetën, por e lëshon veten në detin e të vërtetës.

Mendimi perëndimor ka marrë vendim se njeriu në mënyrë të pavarur mund ta përdorë mendjen dhe se disponon me të gjitha ingerencat e manipulimit me të. Një mbështetje kaq kuturu ndaj epshit, për rrjedhim e ka pranimin e kushtëzimeve si e drejtë absolute. Nëse mendja jonë gjendet nën hijen e disa kushtëzimeve është gabim të jemi plotësisht të sigurt në funksionimin e saj. Deri te e vërteta arrihet duke menduar, por assesi me një sistem të shtrembëruar të të menduarit. Mundësinë dhe privilegjin e arritjes deri te mendimi i drejtë e kemi vetëm atëherë nëse mbrojtjen e intelektit tonë ia lëmë (besojmë) Zotit.

"Njeriu i cili nuk e humbë mendjen para disa ngjarjeve, nuk disponon me mendje të cilën do të ketë mundësi ta humbë", - thotë G. E. Lessing. Sipas meje, duhet ta kërkojnë mendjen, humbja e së cilës është një posibilitet, sepse bota në të cilën jetojmë dëshiron të na sjellë në një gjendje kur nuk do të përjetojmë asnjë tronditje mendore përballë kurrfarë

ngjarjeje. Bota e kushtëzimeve mendimin e prezenton si një operacion matematikor, si një veprimtari kompjuterike. Natyrisht se kur njeriu përfytyrohet si një kompjuter, edhe mendja e tij do të përfytyrohet si një mendje që nuk mund të humbet. Bota e sipërpërmendur shpreh idenë se çdo gjë është e shpjegueshme dhe çdo gjë mundohet ta shpjegojë në mënyrë racionale. Mospërdorimi i mendjes u shkon për shtati disa të tjerëve. Nëse çdo gjë përfshihet nga mendja, nëse njeriu nuk e humbë mendjen në momentin kur realizohen disa ngjarje, mund të themi se te i njëjti nuk ekziston ndonjë aktivitet mendor. Qytetërimi perëndimor mendjen e pranon si një mekanizëm i cili sipas nesh "nuk ka ndonjë aspekt të kapshëm përmendjen". Jemi të detyruar ta përfitojmë mendjen tonë përballë mendjes moderne (racios - A.P.).

KOKA E SHËNDOSHË

Një kohë në shkollë nxënësve u ngulitej në mbamendje kjo fjali: "Koka e shëndoshë në trup të shëndoshë". Unë asnjëherë nuk i kam kuptuar këto fjalë. Ç'kokë është koka e shëndoshë? Një kokë që nuk thyhet kollaj ose një kokë e trashë? Nëse është e atillë, atëherë pse njerëzit akuzohen për kokëtrashësi? Apo vallë dëshirohet të thuhet se edhe këmbët edhe koka duhet të jenë të shëndosha? Ose, njeriu për të menduar mirë duhet që t'i punojnë mirë të gjitha organet e trupit, duhet që trupi të jetë në top-formë? Nuk është ashtu. As shëndeti i kokës përcaktohet nga shëndeti i trupit, e as që mund të thuhet se njerëzit me të meta trupore edhe mendimet i kanë me të meta. Sikur që të marrët mund të kenë muskuj dhe metabolizëm të shëndoshë, po ashtu edhe te gjenitë hasim të meta trupore si edhe syresh të sistemit nervor. Bile bile shumë shpesh shënohen raste kur "kokat" që mendojnë drejt dhe janë të zhvilluara, në aspekt të aftësive trupore (fizike) janë të pazhvilluara.

"Koka e shëndoshë në trup ta shëndoshë" të përkujton rininë e Hitlerit. Rinia gjermane që e përgatiti Gjermania naziste, fizikisht ishte shumë e shëndoshë. Por është diskutabile çështja se sa ata ishin të zhvilluar shpirtërisht. Me sa duket, botëkuptimi racist a priori e kish pranuar idenë se rezultat i trupit të shëndoshë është koka e shëndoshë, kështu që thuhet se në pajtim me kushtetutën e Gjermanisë hitleriane, me qëllim të "prodhimit" të gjermanëve idealë ishin ngritur ferma të njerëzve. Kush e di, ndodh që shëndeti i shpirtit ose kokës është në proporcion negativ me shëndetin e trupit?! Fort mirë dihet se nuk ka shumë kundërshtime lidhur me qëndrimin se përparimi material e përshpejton shembjen ose degradimin shpirtëror. Ndoshta njerëzit që fizikisht janë mjaft të shëndoshë bëhen më indiferentë, më insensitivë. Për këtë arsye shëndeti fizik nuk e siguron shëndetin e tyre shpirtëror.

Sot me qëllim të zhvillimit të shëndoshë të foshnjave mobilizohen të gjitha mundësitë dhe me lehtësi evitohen çekuilibret në trupin njerëzor. Por ky tip i njeriut të shëndoshë, në shumë aspekte a nuk i bartë pasojat e frenit të tij ideor dhe konceptual? Por, ndal! Duke synuar përmirësimin e një gabimi le të mos biem në një gabim tjetër! Le të mos arrijmë në përfundimin se për të menduar drejt dhe për të qenë i shëndoshë shpirtërisht, duhet qenë i dobët dhe jo i shëndoshë. Ne nuk themi se "nëse mendojmë drejt, shëndeti i trupit nuk është i rëndësishëm". Le të mos mbizotërojmë mendimi se për ta shpëtuar shpirtin duhet harxhuar trupin tonë. Nuk duhet harruar se vlerat morale të strukturës shoqërore në të cilën jetojmë duhet ngritur në lidhshmëri me shëndetin fizik-trupor. Le të dimë se vendet e pasura të kohës sonë paraqesin shoqëri të sëmura, të përbëra nga njerëzit me trup të shëndoshë. Përkundër kësaj, shoqëritë e varfëra sëmunden në fjalë janë duke e përjetuar dyfish. Kjo, për arsye se vendet e njëjta jo vetëm që vlerat e veta morale i programojnë sipas kriterëve të vendeve të pasura, për në ndërkohë janë duke e përjetuar edhe vuajtjen e të mbeturit në një pikë të mjerueshme në aspekt të nivelit të mirëqenies.

Shoqëritë nuk sëmuren nga specifikat si uria, varfëria, inflacioni, papunësia ose shpërdorimi i të drejtave njerëzore. Deformimet si këto mund të flaken me metoda të cilat shoqërinë e ndihmojnë të funksionojë më në rregull. Shoqëritë e sotme nuk sëmuren si pasojë e alkoolizmit, prostitucionit, kumarit (bixhozit), rryshfetit dhe anomive të ngjashme. Si varfëria ashtu edhe sjelljet shoqërore anomike paraqesin refleksione të deformimit të themelit. Deformimi i themelit është humbja (në masë të madhe) e besimit në metafiziken, transcendentalen.

Për këtë arsye sot, njerëzit me fizikus ose trup të shëndoshë e kanë vështirë të jenë të shëndoshë edhe shpirtërisht. Por këta njerëz besojnë se me kokë dhe shpirt kaq të sëmurë do të mund t'i zgjidhin çështjet e ndryshme jetësore. Sot gjendja e botës është identitet i sëmundjes, identitet i traumës serioze. Kjo botë nuk do të arrijë të shpëtojë përderisa nuk i braktis "vlerat e veta të gjykimit", përderisa nuk i braktis vlerat që i mbron. Ky shpëtim, pa marrë parasysh hapësirën gjeografike, do të mund të realizohet në saje të ndryshimit rrënjësor të mendimeve, koncepteve, respektivisht në saje të kthimit besimit në transcendentalen (gajb). Njerëzit, kur ta rivlerësojnë jetën e vet, kur t'i ndryshojnë botëkuptimet e veta, do të shohin se sigurimi i shëndetit shpirtëror nuk qëndron në shëndetin fizik-trupor.

ALKIMIA E SHEKULLIT TONË

Baudelaire duke iu drejtuar Parisit thotë:

Më dhë baltën tënde, e shndërrova në ar.

Gjendja për të cilën flet poeti paraqet një alkimizëm të ri (neoalkimizëm), një kuptim që mundohet të përfitohet nga një jetë e pavlefshme, një përpjekje e poetit për të arritur një ishull dhe një strehimore në saje të botës poetike.

Vallë, ari që e ka bërë Baudelaire në Parisin plot baltë të shekullit XIX, pa e ndriçuar jetën e vet, ç'dobi do t'u sigurojë brezave të ardhshëm pos transmetimit të një fushe të hulumtimit? Përfitimi i arit - në botën e poezisë - nga balta, paraqet një alkimi karakteristike të kohës sonë. Përvoja e Baudelaire-it, pa marrë parasysh ndikimin e jehonën deri në ditët tona dhe shërbimin që ia ka bërë hapësirës sonë të përkapjes, nuk është asgjë tjetër pos kristalizim i indiferentizmit të njeriut bashkëkohor. Ky lloj i metalit, ky kristal nuk ka ndonjë kuptim të madh përderisa nuk zhvillon një fuqi që do ta përmbysë të keqen që e ndytë jetën në një arë pjellore. Kjo ndjenjë shumë e vlefshme e ikjes, përderisa dominon me tërësinë e botëkuptimit, mund të jetë edhe prapësuese. Njeriu për të pasur mundësinë për të marrë një frymë bëhet sikur nuk e sheh tërësinë, madje për ta forcuar këtë strehimore e përdorë edhe një pjesë të së keqes. Njëra nga figurat e veprës së Sartre-it Rrugët e lirisë, Mathieu, nuk e dëshiron shembjen e borgjezisë, sepse po që se shembet borgjezia nuk do të ketë kë ta urrejë dhe në këtë mënyrë do t'i ikë duarsh ndjenja të cilën ai e ka zgjedhur si hapësirë të rehatimit të vetvetes. Strehimorja më e rëndësishme të cilën e jeton heroi i romanit në jetën përplot vuajtje, është urrejtja që ai e ndjenë ndaj një klase shoqërore. Nëse nuk ekziston ajo klasë, as ai nuk është i qetë. Kuptimi të cilin Baudelaire në saje të alkimisë e ka nxjerrë nga balta e Parisit dhe Mathieu nga urrejtja ndaj borgjezisë, nuk i shpëton as ata dy e as të tjerët. Vetëm se, në saje të ishullit që e kanë futur në dorë ndiejnë pak rehati. Në kornizat e lëvozhgës së vet, shpirtin e vet e konsiderojnë të shpëtuar.

Alkimia, në të shumtën e rasteve nuk është përpjekje e njerëzve për ta gjetur prehjen. Programi politik i kapitalizmit, që prej kohës kur u lind e deri më sot, ngërthen në vete njëfarë alkimie. Përpjekja për të nxjerrë ar nga një mineral i pavlefshëm ka filluar t'i pushtojë njerëzit. Me Luftën e Dytë Botërore janë paraqitur formula të alkimisë që janë munduar të zbatohen në praktikë: regjimi sovjetik në Rusi, sistemi nacional-socialist në Gjermani, fashizmi në Itali. Ky lloj i alkimisë e ka ruajtur atraktivitetin e vet deri në vitet '60 të shek. XX.

Në një periudhë kohore, mendjet e qytetarëve të vendeve të quajtura "të pazhvilluara", i patën preokupuar fjalët boshe për "rrugën jokapitaliste". Derivimi nga sistemi që e ka shtypur njeriun i një sistemi shoqëror në të cilin sovranitetin do ta marrë në duart e veta njerëzimi! T'i bësh të besojnë turmat njerëzore se shpëtimi qëndron në një klasë të cilën e ka lindur kapitalizmi, në një racë superiore apo në sistemin korporativ? Në rregull, po cili është minerali i pavlefshëm që përdoret në operacionin alkimik? Domethënë, qytetërimi teknologjik do të shndërrohet në parajsë me elementet e vetë atij qytetërimi ose me vlerat që i ka krijuar sistemi makinerik? Si mossukses në eksperimentet alkimike për krijimin e arit nga bakri, ashtu edhe të gjitha eksperimentet shoqërore, kanë treguar se aventurat që për lëndë të parë e përdorin humanizmin borgjez nuk mund të shkojnë përtej ruajtjes së thelbit të vet. Regjimi sovjetik krijoi një sistem të ri borgjez, Gjermania naziste, Italia fashiste, Egjipti nasirian përgjatë periudhës kur "jetuan" nuk arritën gjë përveç të qenët nga një dinamо e mundimit dhe vuajtjeve.

Aktualiteti paraqet një periudhë kohore kur - edhe pse të dobëta - janë duke u bërë eksperimente të alkimisë. Në shoqëritë ku jetojnë muslimanët, përpjekjet për shndërrimin e disa elementeve të qytetërimit perëndimor në ar, në këtë ose në atë mënyrë, ende e ruajnë gjallërinë e vet. Dëshirohet që forma e re që ka marrë jeta të përjetojë një metamorfozë në raport me qëllimet tona. Në shekullin e elektronikës mund të parashtrohet pyetja se si do të arrihet që në saje të mundësive të këtij shekulli të realizohet revolucioni pas të cilit do të vihen themelet e një sistemi shoqëror ideal. Përpjekja për shndërrimin e bakrit në ar te disa muslimanë ende është in (ende është aktuale).

I Dërguari i Zotit na ka treguar vetëm një rrugë në të cilën duhet ecur. Ai nuk e ka përmirësuar shoqërinë injorante (paraislame) dhe institucionet e saj. Njerëzimit i ka sugjeruar një sjellje të pandashme të robërimit ndaj Zotit dhe në këtë aspekt i ka dhënë shembujt më të shkëlqyeshëm. Në Shekullin e Lumturisë (Asr-i Saâdet) koka idhujtare nuk është shndërruar në kokë besimtari duke përjetuar revolucion. "Besimi" (îmân) i ka vënë themelet e sovranitetit të vet të palëkundshëm. Është gjetur ari por nuk është krijuar në saje të bakrit.

TREGUESI

A

adoleshenca, 33, 95
ardhmëria, 9,10
‘asabijje, 55
abstraksionet sociologjike, 48
Ademi (a.s.), 41,50
afarizmi, 39
alkimia, 119, 120, 121
All-llahu (xh.sh.), 41, 69
analfabetizmi, 99
Annie Vivanti, 28
antagonizmat, 73
arsimi, 24, 82, 85
Arthur Rimbaud, 27
artisti, 15, 19, 21, 22, 79
asimilimi, 46
automatizimi, 110

B

Baudelaire, 119, 120
Bernard Shaw, 47
besimi, 42, 50, 51, 75, 76, 78, 81, 97, 98, 102, 103, 107, 109, 110, 117, 121
bestytia, 96, 97
borgjezia, 120
Bostoni, 26
bota barbare, 55
bota moderne, 91

bota e përhershme (ahireti), 109

botëkuptimi, 40, 43, 45, 46, 49, 57, 64, 81, 87, 95, 97, 99, 102, 103, 110, 111, 116, 117

C

Cambridge, 20

Chuang Tzu, 13

credo, 98

Ç

Çekosllovakia, 34

çështjet e pazgjidhshme, 97, 98

D

destruksioni, 94

Danton, 105, 106

Darwin, 50

David Ehrenfeld, 97

degradimi shpirtëror, 19

Descartes, 33
despotizmi, 71, 107
dinamizmi kulturor, 18
Dita e Fundit, 59
dituria, 16, 34, 50, 51, 95
dija trajtësore, 89, 90, 91, 92
doktrina, 19, 25, 77
E
e shenjta, 10
e Vërteta (el-Hakk), 76
ebed, 40
eksperimenti, 82, 94, 95, 107, 121
ekstaza, 94
ekstern/ekzoterik, 96
ekstremistët, 25
ekzistenca, 65, 106
emocionet, 10, 69, 76, 110, 111
enigma, 76
estetika, 81
Evropa, 94
evropianët, 19, 20, 41, 94, 95
ezel, 40
F
familja, 112
fashizmi, 120
fenomeni, 34, 40, 47, 56, 69, 80, 83, 95
filozofia, 71, 95
fuqitë perëndimore, 54, 55, 105
G
G. E. Lessing, 113
Galia barbare, 56
Gj
gjithësia, 41, 49, 65
H
hegjemonia, 54, 55, 57
Heidegger, 23
hiperkonsumimi, 61
hipoteza, 50, 97, 98
Hitleri, 115
homo faber, 11, 40, 49, 53
homo sapiens, 11, 40, 49, 53
hulumtimi, 119

humanisti, 51, 97, 98, 99
humanizmi, 50, 97, 98, 121
I
i urti, 37, 38

Ibën Halduni, 55
ideal, 9, 116, 121
identitetet kulturore, 48
ideologjia, 11, 16, 28, 30, 45, 92
idhullthyesi, 9
iluminizmi, 94, 95
iluzioni, 9, 11, 73, 83
indiferentizmi, 119
industrializimi, 23
inflacioni, 93, 117
intelekti, 85, 86, 91, 113
intelektuali, 24, 25, 65, 91
intern/ezoterik, 96
intuita, 112
inzheneringu gjenetik, 93
islam, 9, 10, 11, 77, 81, 101, 102, 103, 110, 111, 121
J
jeta artificiale, 80
Joseph de Maistre, 46
K
kaderi, 17
kauza, 106, 107, 110
kisha e humanizmit, 50
kolektiviteti njerëzor, 80
komunikimi, 25, 72, 86, 93
koncepti, 40, 50, 63, 68, 96, 106, 107, 109m 117
kontrata, 41, 43
krahasimi, 29, 30, 55
Krijuesi, 41, 42, 76
Krishterimi, 47
Kur'ani, 76, 102, 110, 112
kushtet lëndore, 68
kushtëzimet, 24, 77, 93, 111, 112,
L
La Rochefoucauld, 31
Laforgue, 23
Le Petit Robert, 20
Lufta e Dytë Botërore, 24, 54, 120
lumturia, 8, 9, 60
M
mâ sivâ, 69
Marx, 50
Massachusetts, 34
mass-mediumet, 84, 92, 95, 103
Mathieu¹²⁰
Maurice Maeterlinck, 75
mendimi, 15, 16, 17, 21, 23, 24, 28, 47, 71, 72, 92, 94, 95, 106, 107, 109, 111, 112, 113,
116

Mesjeta, 47
metropoli, 25
misionarët e qytetërimit, 82, 83
modernizimi, 83
modus vivendi, 56, 64,, 81
mosbesimi (kufi), 42
mosrehatia, 89, 91, 92, 93
muslimani, 9, 71, 75, 76, 79, 96, 98, 101, 102, 103, 121
N
ndjenja narcisoide, 30
nefsi (egoja, epshi), 42
neoalkimizmi, 119
nomadizmi, 55
Nj
njerëzimi, 11, 17, 46, 60, 71, 72, 81, 82, 84, 90, 111, 120, 121
njeriu, 15, 16, 17, 21, 25, 28, 29, 30, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 59, 60, 61, 79, 80, 90, 91, 92, 93, 99, 104, 107, 115, 116, 119, 120
njeriu i mërzitur, 16, 17, 30, 31
njëshmëria (tevhîd), 101
njohuria, 36, 37, 42, 47, 48, 49, 51, 62, 72, 85, 90, 93
O
oksidantalizimi (westernizimi), 35
ontologjia, 63, 64, 66, 67, 69
operacioni matematikor, 113
P
perceptimi, 40, 63
përfytyrimi, 30, 31, 110
përkufizimi, 43, 89, 90, 110
përparimi linear, 9
poezia, 16, 24, 25, 81, 119
prodhimi, 42, 54, 80, 92, 116
progresi, 11, 92, 116
puritanizmi, 19
Q
qendra, 23, 25, 102
qenia, 46, 59, 65, 48, 110
qytetërimi, 9, 41, 47, 50, 53, 65, 82, 94, 95, 96, 58, 110, 113, 113, 121
qytetërimi perëndimor, 41, 51, 54, 57, 82, 94, 95, 96, 113
R
radikalizmi, 19
raptus, 94
refleksioni, 16, 21, 24, 31, 79, 82, 87, 99, 117
revelacioni (vahj), 62
revolucion shkencor-teknologjik, 24
Revolucioni Francez, 105
Revolucioni Industrial, 80
risalet, 41
Roger Bacon, 94

Roma, 56

S

Sartre, 120

scientia interior, 94

sistemi nacional-socialist, 120

sistemi nervor, 115

Sizifi, 9

sjellja islame, 103

snobi, 22, 23, 24, 25

snobizmi, 9, 19, 21, 23

solidariteti, 28, 67

solidaritetit shoqëror, 67

sporti, 92

standardi, 82

standardizimi, 86

struktura, 23, 24, 37, 42, 49, 50, 54, 95, 109, 110

struktura intelektuale, 19

sunneti 76, 102

Sh

shabllonizimi, 37

Shejh Shihâbuddîn Jahjâ Suhreverdi, 94

Shekulli i Lumturisë (Asr-i Saâdet), 9, 121

Shenjtorja Jan Dark, 47

shëndeti shpirtëror, 64, 117

shkatërimi, 71, 98

shkolla, 72, 75, 112, 115

shkrimtarët, 29, 106

shoqëria shkencore-teknologjike, 26

shpëtimi, 54, 71, 73, 82, 83, 91, 103, 117, 120

shpirti, 40, 50, 80, 85, 106, 116, 120

shpirtëror, 10, 19, 29, 49, 50, 60, 64, 92, 109, 111, 116, 117

shqetësimi, 67, 69, 71, 76, 92, 93

T

Tanzimati, 23, 24

Teilhard de Chardin, 51

teknologjia, 9, 24, 25, 56, 59, 61, 71, 90, 98, 121

të menduarit, 16, 46, 47, 51, 75, 81, 92, 111, 112, 113

toka, 42, 43, 60, 82, 99

transcendental, 10, 98, 117

Turqia, 11, 15, 19, 23, 25, 34, 35, 47, 83, 125

Th

Thomas S. Szasz, 35

Thomas Stern Eliot, 39

V

vdekja, 106, 110

vlera, 22, 43, 46, 53, 62, 64, 65, 66, 68, 81, 87, 94, 102, 106, 108, 111, 116, 117, 121

vlerat morale, 116

W

Webster, 20

westernizimi, 35

Y

Yukio Mishima, 106

Z

Zoti, 11, 12, 16, 39

Zh

zhdanovizmi, 19

zhdukja e njeriut, 59

zhvillimi, 23, 25, 50, 54, 81, 82, 83, 84, 95, 105,